



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**NR. 24 AKTI**

**NR. 35 VENDIMI**

**Tiranë, më 12.07.2018**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	Kryesuese
<b>Suela Zhegu</b>	Anëtare
<b>Pamela Qirko</b>	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. John Leonardo, më datë 11.07.2018, ora 10:00, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:**

**Z. Adriatik Cama**, me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKTI:**

**Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:**

**Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

**Ligji nr. 84/2016** “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015** “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012** “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Pamela Qirko, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht dhe pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

### **VËREN:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

**1.** Z. Adriatik Cama ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe, si subjekt rivlerësimi, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

**2.** Subjekti i rivlerësimit, z. Adriatik Cama, duke qenë kandidat për anëtar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në bazë të nenit 279 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar si subjekt i rivlerësimit me shortin e hedhur më datë 30.11.2017, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit” nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

**3.** Në referim të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, procesi i rivlerësimit ndaj subjektit Adriatik Cama ka filluar menjëherë pasi janë caktuar me short trupat gjykues të Komisionit, si dhe është shortuar shpërndarja e çështjes konkrete më datë 30.11.2017.

**4.** Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 14.12.2017 u caktua me mirëkuptim kryesuese znj. Genta Tafa (Bungo), u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin Adriatik Cama.

5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Adriatik Cama, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, e veçanërisht me nenin 30 të këtij ligji, kishte për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

7. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Grupi i Punës pranë zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm. Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

8. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016 u administrua shkresa me nr. \*\*\* prot., datë 13.11.2017, e **Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI)**, me anë të së cilës dërgohej një raport i hollësishëm dhe i arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Adriatik Cama. Në këtë raport, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me këtë subjekt rivlerësimi, ILDKPKI-ja ka konstatuar se:

- a) *deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
- b) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- c) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- ç) *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- d) *nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

9. **Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)** ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 02.11.2017 (deklasifikuar pjesërisht me vendimin e KDZH-së nr. \*\*\*, datë 23.04.2018) për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar *papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Adriatik Cama.*

10. **Grupi i Punës pranë zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm** ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë

periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

**11.** Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi dy kriteret, atë të vlerësimit të pasurisë dhe kontrollit të figurës.

**12.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe atë të figurës, më datë 05.07.2018, vendosi: i) përfundimin e hetimit kryesisht për këto dy kriteret për subjektin e rivlerësimit, z. Adriatik Cama; ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**13.** Subjekti i rivlerësimit, më datë 06.07.2018 u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes më datë 09.07.2018 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja më datë 16.07.2018.

**14.** Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

## **II. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**15.** Z. Adriatik Cama nuk ka qenë gjithmonë bashkëpunues gjatë këtij procesi rivlerësimi, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, duke dërguar deklaratimet e tij përtej afateve të caktuara.

## **III. SEANCA DËGJIMORE**

**16.** Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, me *e-mail*, më datë 05.07.2018.

**17.** Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Adriatik Cama, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, më datë 11.07.2018, ora 10:00, në Sallën e Konferencave në Pallatin e Koncerteve, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. John Leonardo.

**18.** Subjekti i rivlerësimit, z. Adriatik Cama, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj

tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Adriatik Cama, kërkoi nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit konfirmimin në detyrë.

#### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**19.** Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

**19.1.** Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

**19.2.** Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

**19.3.** Ndërsa, sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

**19.4.** Por, referuar Vendimit të Gjykatës Kushtetuese Nr. 2/2017<sup>[1]</sup> dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

**20.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:  
(a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së me “Deklaratën e Pasurisë për

---

<sup>[1]</sup> “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga KPK-ja, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr.84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja; (c) Deklarata e Rivlerësimit Kalimtar-Vetting dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga ana e subjektit në ILDKPKI; ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga DSIK-ja (dh) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

**21.** Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti dhe ligjshmërisë së burimit dhe të krijimit të saj.

Dokumentacioni i analizuar përbëhet nga:

- Provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së;
- Provat e depozituara nga subjekti pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit;
- Informacionet dhe të dhënat e administruara nga ky Komision nëpërmjet organeve shtetërore, personave fizikë dhe juridikë.
- Shpjegimet dhe deklaratat e subjektit në përgjigje të pyetësorëve të drejtuar nga Komisioni, të rezultateve të hetimit administrativ dhe shpjegimet e dhëna në seancën dëgjimore.

**21.1.** Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklarimeve të interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Adriatik Cama, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të Deklaratës së Rivlerësimit Kalimtar të datës 31.01.2017, me nr. indeksi \*\*\*, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI, për vitet 2003 - 2016, në raport me të dhënat e Deklaratës së Rivlerësimit Kalimtar;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga bankat, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve - gjendje *cash*;
- ç) hetimeve të kryera lidhur me të dhënat e vetëdeklaruara nga subjekti i rivlerësimit kalimtar, gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

➤ **Në Deklaratën-Vetting, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar këto pasuri (të paluajtshme dhe të luajtshme):**

**22. Pasuria nr. \*\*\***, e ndodhur në Tiranë, zona kadastrale \*\*\*, Rr. “\*\*\*\*”, ndërtesa \*\*\*, hyrja \*\*\*, apartamenti \*\*\*. Lloji: apartament, me sipërfaqe 76.73 m<sup>2</sup>; në vlerën 3,400,000 lekë. Pjesa takuese: 50 %.

**22.1. Burimi i krijimit të pasurisë në Deklaratën-Vetting:**

- Të ardhurat e krijuara nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, në vite. Mban shënimin: “*Referohu formatit të të ardhurave*”.

**22.2. Mënyra e fitimit të pasurisë:**

Kontrata e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 11.04.2011, me anë të së cilës subjekti ka blerë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. pasurinë e deklaruar.

**22.3. Arsyetimi ligjor**

Nga hetimi administrativ konstatohet se kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në deklaratën e vitit 2003 në vlerën prej 2,400,000 lekësh. Referuar kësaj deklarate, subjekti ka deklaruar shtëpi banimi 2+1, ende të pahipotekuar, të ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë. Si burim të krijimit ka deklaruar kursimet disave familjare. Po në këtë deklaratë, konstatohet se subjekti nuk ka deklaruar detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë. Në Deklaratën-Vetting, kjo pasuri është deklaruar në vlerën prej 3,400,000 lekësh.

**22.4.** Referuar shkresës së ardhur nga ZVRPP-ja Tiranë, me nr. \*\*\* prot., datë 14.02.2018, konfirmohet pasuria e regjistruar në favor të subjektit të rivlerësimit me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, faqe \*\*\*, e ndodhur në zonën kadastrale \*\*\*, apartament me sipërfaqe 76.73 m<sup>2</sup>. Në dokumentacionin që shoqëron dosjen e kësaj pasurie është administruar edhe kontrata e shitblerjes së kësaj pasurie, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 11.04.2011, sipas së cilës çmimi i shitjes për sipërfaqen e banimit të këtij apartamenti është në vlerën prej 29,157 USD dhe se çmimi i shitjes për sipërfaqen e përbashkët është në vlerën prej 5,768 USD, nga ku në total **çmimi i shitjes së këtij apartamenti është në vlerën prej 34,925 USD** -shumë e cila pasqyrohet në kontratë se është likuiduar që në kohën e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes në vitin 2003.

**22.4.1.** Nga konvertimi i çmimit të shitjes me kursin mesatar vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2003, vlera e këtij apartamenti është në shumën prej 3,795,998 lekësh<sup>1</sup>, ndërsa nga konvertimi i çmimit të shitjes me kursin mesatar të Bankës së Shqipërisë për muajin janar të vitit 2017

---

<sup>1</sup> Kursi mesatar i vitit 2003, sipas Bankës së Shqipërisë, është 1 USD me 108.69 lekë.

(moment kur është bërë deklarimi i kësaj pasurie në Deklaratën-Vetting), vlera në lekë e këtij apartamenti, referuar çmimit të shënuar në kontratë, është prej rreth 4,484,370 lekësh<sup>2</sup>.

**22.4.2.** I pyetur lidhur me çmimin e blerjes së këtij apartamenti, në deklarimin e tij të depozituar pranë këtij Komisioni, *subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar se çmimi i blerjes së kësaj pasurie është në vlerën prej 34,925 USD* dhe se nuk e disponon kontratën e prenotimit të apartamentit.

**22.4.3.** *Sa më sipër, referuar deklaratës së vitit 2003 dhe Deklaratës-Vetting, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë lidhur me vlerën e blerjes së apartamentit.*

**22.5.** Pasi iu dërguan rezultatet e hetimit administrativ dhe iu kalua barra e provës në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, subjekti i rivlerësimit, më datë 02.07.2018, nëpërmjet postës elektronike ka dërguar shpjegimet e tij dhe prapësimet lidhur me to. Në pikën 2 të këtyre prapësimeve, subjekti i rivlerësimit parashtron prapësimet e tij, duke dhënë shpjegimet për gjetjen e bërë nga ana e këtij Komisioni, lidhur me deklarimin e rremë të vlerës së blerjes së apartamentit.

**22.5.1.** Siç e kemi evidentuar edhe në rezultatet e hetimit, është konstatuar se subjekti i rivlerësimit në deklaratën fillestare të Deklarimit të Pasurive dhe Interesave Private të vitit 2003 ka deklaruar vlerën e apartamentit prej 2,400,000 lekësh, ndërsa në Deklaratën-Vetting e ka deklaruar në vlerën prej 3,400,000 lekësh.

**22.5.2.** Në shpjegimet e tij përfundimtare, subjekti pranon se nga ana e tij është bërë deklarim i pasaktë i vlerës së blerjes së apartamentit në DPV-2003, nga 3,4 milionë në 2,4 milionë. Në vijim, ai pretendon se kjo pasaktësi është relatuar nga ana e tij në ILDKPKI, në fillim të vitit 2015 ose 2016 (*por nuk ka sjellë dokumentacion provues*), në momentin që thotë se ka konstatuar se nuk përkonte vlera e deklaruar nga ana e tij me vlerën e pasurisë sipas kontratës së shitblerjes, të datës 11.04.2012, ku përcaktohet çmimi total i blerjes së këtij apartamenti në vlerën prej 34,925 USD.

**22.5.3.** Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se diferencën nga çmimi real i shitjes së banesës prej 3,400,000 lekësh, -për të cilin thotë se është likuiduar nga ana e tij në dhjetor të vitit 2003- me atë të pasqyruar në kontratë, që sipas vlerësimit me kursin vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2003 duhej të ishte 3,795,998 lekë, -diferencë e cila kap vlerën prej 395.998 lekësh, - nuk e ka paguar asnjëherë te shoqëria ndërtuese.

**22.5.4.** Subjekti i rivlerësimit shpjegon se, sipas marrëveshjes me shoqërinë ndërtuese në momentin e blerjes së apartamentit, kryerjes së pagesës së menjëhershme nga ana e tij në fundin të dhjetorit të vitit 2003 dhe vonesave në regjistrimin e kësaj pasurie në ZVRPP prej shoqërisë ndërtuese, nuk i është kërkuar që të mbulohet kjo diferencë dhe as është paguar ndonjëherë kjo vlerë nga ana e tij.

---

<sup>2</sup> Kursi mesatar i këmbimit i Bankës së Shqipërisë, për muajin janar 2017, është 1 USD me 128.4 lekë.

**22.5.5.** Për të provuar këtë fakt, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar marrjen e dëshmisë së administratorit të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., z. R.Z.

**22.5.6.** Lidhur me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, **argumentojmë se rezultatet e hetimit të kryer nga ana e Komisionit lidhur me këtë gjetje mbështeten në prova shkresore: në kontratën noteriale të shitblerjes së kësaj pasurie, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 11.04.2011,** sipas së cilës përcaktohet çmimi i shitjes për këtë pasuri, në total në vlerën prej 34,925 USD; **në deklaratat e interesave private dhe pasurore të paraqitura në ILDKPKI,** të cilat bazuar në pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 janë përdorur si provë nga ana e këtij Komisioni, si edhe **në vetëdeklarimin e bërë nga ana e subjektit të rivlerësimit pranë këtij Komisioni.**

**22.5.7** Gjithashtu, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë provë ku të dokumentojë çmimin e pretenduar prej 3,400,000 lekësh për blerjen e kësaj pasurie, madje as kontratën e porosisë së pretenduar si të lidhur me shoqërinë ndërtuese në vitin 2003.

**22.5.8.** Referuar nenit 659 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë: “Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike”. Neni 660 i Kodit Civil parashikon se: “Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi”. Neni 663 i Kodit Civil përcakton kushtet e nevojshme për lidhjen dhe vlefshmërinë e kontratës, të cilat janë: “Pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin; shkaku i ligjshëm në të cilin mbështetet detyrimi; objekti që formon lëndën e kontratës dhe forma e saj e kërkuar nga ligji”. Ndërsa neni 690 i Kodit Civil parashikon se: “Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të prishet ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj”.

**22.5.9.** Në zbatim të dispozitave të mësipërme, ky trup gjykues vlerëson se nuk ekziston asnjë shkak ligjor që të vërë në dyshim vërtetësinë e fakteve të përshkuara në **kontratën noteriale të shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., të datës 11.04.2011,** përfshirë këtu edhe çmimin e përcaktuar nga palët.

**22.5.10.** Lidhur me kërkesën e subjektit të rivlerësimit, për të marrë dëshmi nga shtetasi R.Z., në cilësinë e administratorit të shoqërisë ndërtuese ku ai ka blerë apartamentin, nga Komisioni është vendosur që kjo kërkesë nuk mund të merret parasysh, pasi vlerësohet se është bërë me qëllim zvarritjen e gjykimit.

**22.5.11.** Nga Komisioni është konstatuar se ky shtetas, edhe më parë ka bërë deklarata në favor të subjektit të rivlerësimit, me qëllim “korrigjimin/ndryshimin” e çmimit të përcaktuar në kontratën e shitblerjes dhe justifikimin e çmimit të deklaruar të blerjes së këtij apartamenti, nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI.

**22.5.12.** Sa më sipër, bazuar në pikën 6 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin e datës 05.07.2018, trupi gjykues ka vendosur të refuzojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit për thirrjen e këtij dëshmitari.

**22.5.13.** Lidhur me këtë vendim të trupit gjykues, arsyetojmë si më poshtë:

Në përgjigje të kërkesës së dërguar nga ana jonë<sup>3</sup>, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. na dërgon informacion<sup>4</sup> lidhur me marrëdhënien e saj me subjektin e rivlerësimit ku, ndër të tjera, sqaron se:

*“...Midis shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe shtetasit Adriatik Cama është lidhur një kontratë sipërmarrjeje për apartamentin në rrugën “\*\*\*\*” dhe se gjithashtu edhe kontrata e shitblerjes për këtë pasuri. Lidhur me pagesën e kryer nga z. Adriatik Cama, për blerjen e këtij apartamenti, sqarohet se është kryer cash dhe se është pasqyruar në mandatpagesat në bilancet e shoqërisë ndër vite”.*

**22.5.14.** Gjithashtu, krahas kontratës noteriale të shitblerjes së apartamentit, kjo shoqëri na ka dorëzuar edhe një **deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 01.10.2012**, të nënshkruar nga shtetasi R.Z. dhe të redaktuar nga notere A.S., e cila ndër të tjera pasqyron se:

*“...Administratori i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., z. R.Z., deklaron se me z. Adriatik Cama ka lidhur një kontratë sipërmarrjeje midis palëve më datë 01.12.2003, me vlerë prej 27,000 USD, për një apartament në rrugën “\*\*\*\*” dhe se nga z. Adriatik Cama ka marrë shumën prej 2,400,000 lekësh të shtrirë në kohë nga fundi i vitit 2002 deri në fillim të vitit 2003. Në vijim, deklarohet se, “Sipas kërkesës së porositësit, meqenëse në momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes çmimi për metër katror kishte pësuar rritje të konsiderueshme, në kontratën e sipërmarrjes nuk është vendosur vlera reale e lekëve që i ishin dhënë, por çmimi prej 27,000 USD, për të justifikuar rritjen faktike të çmimit nga momenti i lëvrimit të lekëve e deri në momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes. Deklaruesi, z. R.Z., deklaron se e harton këtë kontratë noteriale me kërkesën e porositësit, z. Adriatik Cama, për ta paraqitur në ILDKPKI.”*

**22.5.15.** Nga analizimi i përgjigjes së ardhur nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., e konkretisht të deklaratës noteriale të përshkruar si më sipër, vihen re të dhëna kontradiktore, qoftë brenda kësaj deklarate, po ashtu edhe krahasuar me vetëdeklarimin e bërë nga ana e subjektit të rivlerësimit.

**22.6.** Nisur nga sa më sipër, Komisioni e vlerëson këtë deklaratë noteriale fiktive dhe që është bërë me qëllim justifikimin e çmimit të blerjes së apartamentit të deklaruar nga subjekti në DPV-2003. Kjo, për faktin se:

- referuar dokumenteve të administruara në dosje, ky subjekt ka qenë objekt kontrolli nga ILDKPKI-ja në vitin 2012 dhe se kjo deklaratë është përpiluar pikërisht për të justifikuar deklarimin e çmimit të shitblerjes së apartamentit në vlerën prej 2,400,000 lekësh, të vetëdeklaruar më parë nga ana e tij në ILDKPKI;
- deklarata noteriale i referohet një kontrate sipërmarrjeje të lidhur më datë 01.12.2003, por që kjo kontratë nuk disponohet as nga shoqëria ndërtuese dhe as nga subjekti i rivlerësimit;

<sup>3</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.04.2018.

<sup>4</sup> Protokolluar shkresa pranë Komisionit me nr. \*\*\*, datë 24.05.2018.

- referuar kësaj deklarate, konstatohet se pagesat janë bërë nga subjekti i rivlerësimit para lidhjes së kontratës së sipërmarrjes, në kushtet e mirëbesimit ndaj shoqërisë ndërtuese apo administratorit të saj;
- sipas deklaratës, çmimi i shënuar në kontratën e sipërmarrjes është 27,000 USD, ndërkohë që referuar kontratës noteriale të shitblerjes së kësaj pasurie të përpiluar mes palëve më datë 11 prill të vitit 2012, pra rreth tetë muaj para përpilimit të kësaj deklarate, çmimi total i përcaktuar për blerjen e kësaj pasurie është në vlerën prej 34,925 USD, çmim i cili është deklaruar si i likuiduar qysh në momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes në vitin 2003;
- nga përmbajtja e kësaj deklarate, ajo duket se është përpiluar bazuar në kërkesën e z. Adriatik Cama, me qëllim dorëzimin e saj në ILDKPKI;
- i pyetur nga ana jonë lidhur me çmimin e blerjes së apartamentit, subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar çmimin prej 34,925 USD për blerjen e këtij apartamenti.

**22.6.1.** Pra, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, -mbështetur në rezultatet e hetimit administrativ, të cilat i janë paraqitur, sipas rastit nga ILDKPKI apo nga ana e këtij Komisioni, - ka bërë të gjitha përpjekjet për të deklaruar vlera të ndryshme të blerjes së apartamentit nga ajo e përcaktuar në kontratë, e konkretisht dy vlera të ndryshme.

**22.6.2.** *Sa më sipër, konstatohet se ky subjekt në vazhdimësi ka bërë deklarime kontradiktore lidhur me vlerën e kësaj pasurie dhe me këto veprime të tij, ndër të tjera, ka cenuar rëndë figurën dhe integritetin e prokurorit të Republikës së Shqipërisë.*

**22.7.** Komisioni ka kërkuar informacion edhe pranë OSHEE-së për t'u informuar për lidhjen e kontratës për furnizim me energji elektrike në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, ku nëpërmjet shkresës nr. \*\*\* prot., datë 06.02.2018, jemi informuar se sipas sistemit të faturimit, kontrata që i përket subjektit të rivlerësimit për këtë pasuri është hapur më datë 29.07.2004.

**22.8.** Referuar deklaratave periodike vjetore, si edhe të dhënave të përfituara nga dokumentacioni bankar, rezulton se deklaratimet e bëra nga subjekti për adresën e banimit lidhur me apartamentin e blerë në vitin 2003 janë të ndryshme dhe se gjithashtu, në disa raste, edhe subjekti ndërtues të cilit subjekti i rivlerësimit i referohet që i përket objekti i ndërtimit, është i ndryshëm nga ai i cituar në kontratë, pra nuk është shoqëria ndërtuese “\*\*\*”, por është shoqëria ndërtuese “\*\*\*”.

**22.8.1.** I pyetur nga Komisioni lidhur me këtë fakt, subjekti i rivlerësimit deklaroi se këto adresa i referohen së njëjtës pasuri të patundshme (banesës) të deklaruar nga ana e tij ndër vite. Në vijim të deklaratimit ai shpjegon se, për shkak se e gjithë zona për këtë periudhë kohore ka qenë në zhvillim e sipër dhe pa një sistem të saktë adresash, ndryshimi në adresat e deklaruara ka ardhur për shkak të ndryshimeve të tyre në momentin e deklaratimit, por dhe për të saktësuar sa më mirë adresën. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se aktualisht adresa e saktë është rruga “\*\*\*”, ndërtesa nr. \*\*\*, hyrja \*\*\*, apartamenti \*\*\*, kati i \*\*\*, Tiranë.

**22.9.** Gjithashtu, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.05.2008, i jemi drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, me qëllim evidentimin e regjistrimit fillestar të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve të tij.

**22.9.1.** Në shkresën “kthim përgjigje” me nr. \*\*\* prot., datë 22.05.2018, të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, konstatohet se subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij, sipas certifikatës familjare, janë të regjistruar si banorë në Zyrën e Gjendjes Civile të Njesisë Bashkiake Nr. \*\*\*, Bashkia Tiranë.

**22.9.2.** Po ashtu, referuar kësaj shkrese, familja Cama rezulton e regjistruar sipas transkripteve në:

- regjistrin themeltar të regjistrimit të popullsisë së vitit 1950 “\*\*\*\*”, me referencë \*\*\*;
- regjistrin themeltar të regjistrimit të popullsisë së vitit 1950 “\*\*\*\*”, me referencë \*\*\*;
- regjistrin themeltar të regjistrimit të popullsisë së vitit 1974 “\*\*\*\*”, me referencë \*\*\*;
- regjistrin themeltar të regjistrimit të popullsisë të vitit 1974 “\*\*\*\*”, me referencë \*\*\*;

**22.9.3.** Lidhur me këto të dhëna, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *“Regjistrimi për herë të parë në qytetin e Tiranës është bërë në Njësinë Administrative Nr. \*\*\*, Tiranë, është bërë i përkohshëm, për shkak se banesa që ka aktualisht, për periudhën kohore që ka ardhur në qytetin e Tiranës, ndodhej në një zonë tejet informale, në zhvillim e sipër, si edhe nuk kishte statusin e vendbanimit”*. Në vijim të deklarimit, ai shpjegon se: *“Për të mundur akses në shërbimet utilitare për familjen e tij, ka kryer regjistrimin në këtë njësi”*. Për kryerjen e procedurës së regjistrimit deklaroi se, me sa i kujtohet, ka dorëzuar vetëm një certifikatë familjare nga Zyra e Gjendjes Civile Sarandë. Gjithashtu, ai sqaron se në rrugën “\*\*\*\*” nuk ka jetuar në asnjë moment.

**22.9.4.** Lidhur me këto evidencime të kryera nga ana jonë subjekti i rivlerësimit ka dërguar prapësime pranë këtij Komisioni, nga ku arsyetojmë se ato nuk kanë të bëjnë me gjetje që ndikojnë në kriterin e vlerësimit pasuror dhe që të rëndojnë pozitën e subjektit, por thjesht janë konstatime që kanë të bëjnë lidhur me hetimin administrativ të kryer nga ana jonë, për konfirmimin e pasurisë apartament dhe vendndodhjes së tij, të regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit.

**22.9.5.** Bazuar në vetëdeklarimin e subjektit, si edhe në dokumentacionin e administruar në dosje, nga ana e këtij Komisioni është krijuar bindja se kemi të bëjmë me të njëjtin apartament, të ndodhur në të njëjtën adresë, i prenotur nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2003.

**22.10.** Siç e theksuam edhe më lart, subjekti i rivlerësimit në Deklaratën-Vetting ka deklaruar se burimi i të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie janë të ardhurat e krijuara nga ana e tij dhe e bashkëshortes së tij në vite. Konstatohet se edhe në DPV-2003, si burim i krijimit të kësaj pasurie ka deklaruar kursimet disavjeçare familjare.

**22.10.1.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga vetë subjekti i rivlerësimit, rezultoi se ky subjekt dhe bashkëshortja e tij, deri në vitin 2003 kanë gjeneruar të ardhura vetëm nga pagat e

tyre. Si rrjedhim, të ardhurat e krijuara nga ky subjekt dhe bashkëshortja e tij, që kanë shërbyer si burim për krijimin e kësaj pasurie, janë vetëm të ardhurat nga pagat e tyre ndër vite.

**22.10.2.** I pyetur nga ana jonë, nëse ka pasur burim të ardhurash tjetër (të ardhura të tjera), përveç pagave të tij dhe të bashkëshortes përpara vitit 2003, subjekti i rivlerësimit deklaroi duke na konfirmuar se nuk ka pasur të ardhura të tjera përpara vitit 2003, përveç pagave.

**22.10.3.** Sa më sipër, bazuar në nenin 32 të ligjit nr. 84/2016, si edhe në pikën 20 të Udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrimin për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin që në rast se si burim krijimi i pasurisë janë ardhurat nga pagat, deklarimi të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor për të ardhurat neto nga institucioni pranë të cilit ka qenë dhe është i punësuar subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, që mbartin detyrimin për deklarimin e pasurisë.

**22.11.** Trupi gjykues ka evidentuar të ardhurat nga paga neto të realizuara nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar, rezultoi se deri në fund të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë të dokumentuara me dokumentacion justifikues ligjor (vërtetime pagash), të ardhurat neto nga paga të paraqitura në tabelat e mëposhtme:

- *Të ardhurat e subjektit të rivlerësimit deri në fund të vitit 2003.*

**Tabela nr. 1**

<u><b>Periudha</b></u>	<u><b>Funksioni/Institucioni</b></u>	<u><b>Të ardhurat nga paga neto</b></u>	<u><b>Dokumentimi provues</b></u>
15.07.1994-09.09.1995	Hetues, Prokuroria e Rrethit Has	267,549 lekë	Vërtetimi nr. *** prot., datë 18.10.2016, i Prokurorisë Kukës.
01.09.1997-30.06.1998	Drejtues, Prokuroria e Rrethit Delvinë	255,507 lekë	Vërtetimi nr. *** prot., datë 31.10.2016, i Prokurorisë Sarandë.
01.07.1998-31.12.2003	Prokuror, Prokuroria e Rrethit Gjirokastrë	4,102,440 lekë	Vërtetimi, datë 13.10.2016, i Prokurorisë Gjirokastrë.
	<b>TOTALI</b>	<b>4,625,496 lekë</b>	

**22.11.1.** Gjithashtu, ky subjekt për këtë periudhë ka paraqitur:

- Vërtetimin me nr. \*\*\* prot., datë 12.10.2016, të lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, me anë të të cilit vërtetohet se në këtë Prokurori është djegur gjithë dokumentacioni për periudhën nga data 31 gusht 1997 e më parë. Ky vërtetim është lëshuar me kërkesën e të interesuarit, subjektit të rivlerësimit, z. Adriatik Cama.
- Vërtetimin e datës 12.10.2016, të lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë, me anë të të cilit vërtetohet se ish-Prokuroria e Rrethit Tepelenë është djegur gjatë vitit 1997, si pasojë edhe arkivi me dokumentacionin e llogarisë. Bazuar në kërkesën e subjektit të rivlerësimit, me detyrë ish-prokuror sektori, kjo Prokurori konfirmon se nuk kanë asnjë të dhënë për trajtimin financiar deri në mars 1997.

**22.11.2.** Bazuar në vetëdeklarimin e bërë nga ana e subjektit në Deklaratën-Vetting, konstatohet se:

- për periudhën 15.10.1992 deri 14.07.1994 ka punuar në Prokurorinë e Rrethit Tepelenë, duke shpjeguar se për këtë periudhë nuk ka të dhëna lidhur me të ardhurat nga paga neto për shkak të mungesës së dokumentacionit;
- për periudhën 10.09.1995 deri 31.08.1997 ka punuar në Prokurorinë e Rrethit Delvinë, duke shpjeguar se për këtë periudhë nuk ka të dhëna lidhur me të ardhurat nga paga neto për shkak të mungesës së dokumentacionit.

**22.11.3.** I pyetur nga Komisioni se në cilën Prokurori ka punuar, pozicionin e punës, nëse ka pasur shköputje nga puna për këto dy periudha, duke i kërkuar edhe të dhëna lidhur me të ardhurat e përfituara, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit deklaroi se:

*“Nga data 15.10.1992 - 12.12.1992 kam punuar me detyrën hetues në Prokurorinë e Rrethit Tepelenë dhe në vazhdim, nga data 12.12.1992 - 14.07.1994 si prokuror sektori në Prokurorinë e Rrethit Tepelenë. Ndërsa, nga data 10.09.1995 - 31.08.1997 kam punuar në detyrën e zëvendësprokurorit të rrethit në Prokurorinë e Rrethit Delvinë, pa pasur shköputje nga puna (me përjashtim të një periudhe të shkurtër kohore, pas djegies së godinës së institucionit në fillim të muajit mars të vitit 1997)”. Subjekti i rivlerësimit sqaron se **këto të ardhura të përfituara nuk mund t’i saktësojë për shkak të mungesës së informacionit dhe dokumentacionit të djegur gjatë trazirave të vitit 1997, por shpjegon se të ardhurat e tij kanë qenë sipas nivelit të pagës për pozicionin e punës në këto vite**, plus të ardhura nga dieta, shpërblime dhe orët jashtë orarit.*

**22.11.4.** Gjithsesi, bazuar në pikën 2 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, konstatohet se subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokument lidhur me të ardhurat nga paga neto për periudhat përkatëse që ka punuar në këto dy prokurori, fakt të cilin e ka vërtetuar.

**22.11.5.** Për këtë arsye, nga ana e Komisionit është bërë një përlllogaritje e përafërt lidhur me të ardhurat neto që ky subjekt mund të ketë përfituar nga pagat, për periudhën tetor 1992 - korrik 1994 dhe për periudhën shtator 1995 - gusht 1997. Për përlllogaritjen e të ardhurave neto, të cilat subjekti i rivlerësimit mund t’i ketë përfituar për periudhën prej 15.10.1992 deri më 14.07.1994, u

rishikuan të dhënat lidhur me pagat mesatare vjetore për këto vite, referuar vërtetimeve të pagave të paraqitura nga subjekte të tjera rivlerësimit në dosjet e ILDKPKI-së, që kanë kryer funksionin e prokurorit për periudhën në fjalë.

**22.11.6.** Bazuar në verifikimet e kryera, lidhur me të ardhurat vjetore të përfituara nga subjekte të tjera në pozicione të ngjashme me subjektin e rivlerësimit për periudhat përkatëse, kemi evidentuar se të ardhurat totale neto nga pagat vjetore janë në vlerat si më poshtë:

- për vitin 1992, paga mesatare vjetore, në vlerën prej rreth 35,000 lekësh;
- për vitin 1993, paga mesatare vjetore, në vlerën prej rreth 60,000 lekësh;
- për vitin 1994, paga mesatare vjetore, në vlerën prej rreth 91,000 lekësh;

**22.11.7.** Në vijim të analizës së mësipërme,

- paga mesatare mujore neto për vitin 1992 ka qenë në vlerën prej rreth 2,917 lekësh, si rrjedhim nga ana jonë përllogaritet se për këtë vit ky subjekt mund të ketë përfiturar të ardhura totale neto nga pagat në vlerën prej rreth 7,300 lekësh;
- paga mesatare mujore për vitin 1993 ka qenë në vlerën prej rreth 5,000 lekësh, si rrjedhim nga ana jonë përllogaritet se për këtë vit ky subjekt mund të ketë përfiturar të ardhura totale neto nga pagat në vlerën prej rreth 60,000 lekësh;
- paga mesatare mujore për vitin 1994 ka qenë në vlerën prej rreth 7,585 lekësh, si rrjedhim nga ana jonë përllogaritet se për këtë vit ky subjekt mund të ketë përfiturar të ardhura totale neto nga pagat vlerën prej rreth 49,300 lekësh.

**22.11.8.** Sa më sipër, totali i të ardhurave neto të përllogaritura si të përfituara për periudhën 15.10.1992 deri më 14.07.1994 është në vlerën prej rreth 116,600 lekësh.

**22.11.9.** Për përllogaritjen e të ardhurave, të cilat subjekti i rivlerësimit mund t'i ketë përfiturar për periudhën prej 10.09.1995 deri më 31.08.1997, nga ana e Komisionit, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, u evidentua paga neto e muajit gusht 1995 në vlerën prej rreth 20,410 lekësh, si edhe paga neto e muajit shtator 1997 në vlerën prej rreth 22,520 lekësh. Bazuar në këto vlera pagash, nga ana jonë u përllogarit mesatarja e tyre, nga ku rezultati doli 21,464 lekë. Kjo vlerë u përllogarit si paga mesatare mujore neto e përfiturar nga subjekti i rivlerësimit për periudhën shtator 1995 - gusht 1997 (23 muaj).

**22.11.10.** Në bazë të kësaj përllogaritjeje, duke marrë të mirëqenë se ky subjekt ka qenë i punësuar pa shkëputje për këtë periudhë, konstatohet se të ardhurat totale neto nga pagat janë në vlerën prej 493,690 lekësh.

**22.12.** Lidhur me të ardhurat e përllogaritura nga ana e jonë për periudhat për të cilat nuk ka dokument provues, në prapësimet e sjella pranë këtij Komisioni mbas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti rivlerësimit ka kundërshtuar dhe ka kërkuar që të llogariten në vlera pak më të

larta, duke pretenduar se ka dorëzuar dhe dokumentacion provues bashkëlidhur prapësimeve të dërguara me postë elektronike pranë Komisionit.

**22.12.1.** Ky pretendim nuk është marrë në konsideratë nga ana e këtij Komisioni, pasi subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues lidhur me prapësimet e tij dhe se vlerësimi i bërë nga ana jonë lidhur me përlogaritjen e të ardhurave për këtë periudhë është objektiv dhe i drejtë.

**22.12.2.** Me qëllim evidentimin e vendbanimit dhe shpenzimeve të mundshme të qirasë të kryera nga ky subjekt, nga ana jonë është kërkuar që ai të vërë në dispozicion të gjitha adresat ku ka banuar deri në vitin 2004 dhe për shpenzimet e qirasë apo shpenzimet e tjera të kryera lidhur me to.

**22.12.3.** Në përgjigjet e sjella trupit gjykues, subjekti ka deklaruar adresat ku ka banuar përgjatë këtyre viteve, duke shpjeguar se gjithmonë kanë qenë pa pagesë.<sup>5</sup>

- *Të ardhurat e personit të lidhur (A.C.) deri në fund të vitit 2003.*

*Tabela nr. 2*

<b><u>Periudha</u></b>	<b><u>Funksioni/Institucioni</u></b>	<b><u>Të ardhurat nga paga neto</u></b>	<b><u>Dokumenti provues</u></b>
1998-2000	Mësuese, shkolla 8-vjeçare Memaliaj	115,441 lekë	Vërtetimi i Bashkisë Memaliaj
2001-2003	Mësuese, shkolla 8-vjeçare Memaliaj	435,242 lekë	Vërtetimi i Bashkisë Tepelenë
	<i>TOTALI</i>	<i>550,683 lekë</i>	

**22.13.** Sa më sipër, konstatohet se të ardhurat totale nga paga neto të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të deri në fund të vitit 2003 janë në total në vlerën prej 5.786.469 lekësh.

**22.14.** Meqenëse subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur kontratë sipërmarrjeje/prenotimi për blerjen e këtij apartamenti, pra nuk kemi datë të saktë të lidhjes së kësaj kontrate dhe të kryerjes së pagesës, si edhe nisur nga të dhënat që ne kemi se çmimi i blerjes së këtij apartamenti është likuiduar tërësisht në vitin 2003, nga ana jonë blerja e kësaj pasurie do të analizohet së bashku me

<sup>5</sup>Për periudhën tetor 1992 - korrik 1994 deklarohet se ka jetuar në adresën “\*\*\*\*”, Tepelenë, pa pagesë; për periudhën korrik 1994 - shtator 1995 deklarohet se ka jetuar në adresën “\*\*\*\*”, pa pagesë; për periudhën shtator 1995 - dhjetor 1996, deklarohet se ka jetuar në banesën e shtetasit D.P. (djali i hallës), në adresën: \*\*\*, Sarandë, pa pagesë; për periudhën janar 1997 - qershor 1998 deklarohet se ka jetuar në banesën e e shtetasit A.H. (vëhrra e tij), në adresën: Rr. “\*\*\*\*”, \*\*\*, Sarandë, duke shpjeguar se ka kryer vetëm pagesat e ujit dhe energjisë elektrike; për periudhën korrik 2008 - janar 2004 deklarohet se ka jetuar në banesën e shtetasit M.D., pallat me vendndodhje në afërsi të Spitalit Tepelenë.

të gjitha pasuritë e krijuara deri në fund të vitit 2003, të vetëdeklaruar nga ky subjekt sipas DPV-2003.

**22.14.1.** Referuar DPV-2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këto pasuri:

- ❖ **Shtëpi banimi**, vlera sipas kontratës 34,925 USD, konvertuar me kursin mesatar vjetor të vitit 2003 të Bankës së Shqipërisë, në 3,795,998 lekë. Pjesa që zotëron, deklaruar 50 %.
- ❖ **Autoveturë tip “Mercedes-Benz” 190**, vlera e deklaruar 300,000 lekë. Pjesa që zotëron, deklaruar 100 %. Deklaruar si burim i krijimit: Të ardhurat nga paga.
- ❖ **Gjendje cash**, vlera prej 600.000 lekësh. Deklaruar si burim i krijimit: Të ardhurat nga paga.

**22.14.2.** Sa më sipër, konstatohet se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të në fund të vitit 2003 zotërojnë një pasuri totale neto në vlerën prej 4.695.998 lekësh<sup>6</sup>.

**22.15.** Në vijim, nga ana jonë u llogaritën shpenzimet minimale të jetesës, sipas përbërjes familjare, nga tetori i vitit 1992 deri në fund të vitit 2003, nga ku rezulton se:

- Shpenzime jetese për këtë periudhë, rillogaritur në vlerën prej 2.176.786 lekësh<sup>7</sup>.
- ➔ Të dhënat e analizuar më lart, lidhur me pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, për periudhën nga tetori i vitit 1992 - 2003, reflektohen në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 3

Përshkrimi	Vitet 1994 - 2003 vlerat në lekë
1. Të ardhura nga pagat/subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja	5,786,469
2. Shpenzime jetese	- 2,176,786
<b>Të ardhura neto (lekë)</b>	<b>3,609,683</b>
3. Blerë apartament banimi 2+1 në Tiranë, në Rr. “****”	3,795,998
4. Blerë autoveturë, tip “Mercedes-Benz” 190 D	300,000
5. Likuiditete cash në banesë	600,000
<b>TOTAL PASURI (lekë)</b>	<b>4,695,998</b>
<b>Diferenca e pambuluar</b>	<b>- 1,086,315</b>

<sup>6</sup> Vlera e apartamentit prej 34,925 USD, konvertuar me kursin mesatar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2003.

<sup>7</sup> Për periudhën nëntor 1992 - 1993, vlera mesatare mujore e shpenzimeve llogaritur 2,000 lekë në muaj (konsideruar se ju keni qenë i vetëm); për periudhën 1994 - 1996, vlera mesatare mujore e shpenzimeve llogaritur 5,000 lekë në muaj (konsideruar se Ju keni qenë i vetëm); shpenzime për vitin 1997, vlera mesatare mujore e shpenzimeve 10,000 lekë në muaj (Ju + bashkëshortja juaj); shpenzime për vitin 1998, vlera mesatare mujore e shpenzimeve 15,000 lekë në muaj (Ju + bashkëshortja + 1 fëmijë); shpenzime për vitin 1999, vlera mesatare mujore e shpenzimeve 15,000 lekë në muaj (Ju + bashkëshortja + 1 fëmijë) + 5,000 lekë në muaj për 6 muaj për 1 fëmijë nga qershori i vitit 2009), në total shpenzimet janë në shumën 210,000 lekë për këtë vit;  
2000 - 2002, vlera mesatare mujore e shpenzimeve llogaritur 20,000 lekë në muaj (Ju + bashkëshortja + 2 fëmijë); shpenzimet minimale të jetesës për konsum familjar për vitin 2003 sipas ILDKPKI-së, e cila u referohet shpenzimeve të INSTAT-it për konsum familjar, janë përllogaritur në vlerën prej 798,786 lekësh.

**22.16.** Pasi i është kaluar barra e provës në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, subjekti i rivlerësimit, z. Adriatik Cama, ka dërguar prapësimet e tij pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me anë të të cilave, sikurse kemi shpjeguar më sipër, ngre pretendime mbi vlerën e apartamentit, shumën e të ardhurave të përfituara, si edhe të shpenzimeve të llogaritura nga ana jonë për këtë periudhë. Janë vlerësuar nga trupi gjykues me objektivitet të gjitha pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe janë reflektuar ndryshimet përkatëse<sup>8</sup>.

**22.17. Nga analiza e provave dhe fakteve në tërësi, konstatohet se ky subjekt ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara deri në fund të vitit 2003.**

**23. Ambient (ish-parkim/garazh),** të përshtatur, me sipërfaqe 45.56 m<sup>2</sup>, të blerë nga shoqëria ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k., sipas kontratës së sipërmarrjes të datës 15.05.2009 (aktualisht i paregjistruar në ZVRPP), i cili ndodhet në rrugën “\*\*\*\*”, Njësia Nr. \*\*\*, Tiranë. Vlera e deklaruar 18,000 euro. Pjesa në përqindje: 50 %.

**23.1. Burimi i krijimit në Deklaratën-Vetting:**

- të ardhurat familjare të deklaruara;
- kredia në shumën prej 1,000,000 lekësh në “Raiffeisen Bank” (e shlyer);
- huamarrje në shumën prej 6,000 eurosh (hua e cila është shlyer).

**23.2. Mënyra e fitimit:**

Kontratë sipërmarrjeje e lidhur më datë 15.05.2009 mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k.

Arsyetimi ligjor

**23.3. Deklarimet e bëra për këtë pasuri në vite:**

- ✓ Është deklaruar për herë të parë në deklaratën e vitit 2009 në vlerën prej 18.000 eurosh. Referuar kësaj deklaratë, subjekti ka deklaruar shtim pasurie, blerje ambienti (ish-parkim garazh) të përshtatur, me sipërfaqe 44 m<sup>2</sup>, me kontratë sipërmarrjeje të datës 15.05.2009.
- ✓ Si burim të krijimit të kësaj pasurie në DPV-2009, subjekti ka deklaruar të ardhurat nga paga vjetore e tij dhe e bashkëshortes së tij, tërheqja *cash* e sasisë prej 600,000 lekësh më datë 08.05.2009 nga llogaria e kredisë “Midas”, si edhe nga huamarrja e sasisë prej 6,000 eurosh, shtetasit N.S.

---

<sup>8</sup> Është ulur vlera e shpenzimeve për këtë periudhë dhe janë reflektuar ndryshimet përkatëse në analizën financiare, pasi nga ana jonë ishte bërë gabim në përlllogaritjen e tyre, i cili kishte të bënte me evidentimin e saktë të përbërjes familjare të subjektit dhe përlllogaritjen e shpenzimeve vjetore.

- ✓ Në rubrikën “*Të dhëna konfidenciale*” të DPV-2009 deklarohet se disponon kontratën e huamarrjes të datës 02.05.2009, lidhur me huan e dhënë nga shtetasi N.M.S., të cilin deklarohet se është djali i dajës së tij, me profesion ekspert vlerësues.
- ✓ Konstatohet se, referuar DPV-2009, subjekti ka deklaruar detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë:
  - detyrimin ndaj “Raiffeisen Bank”, për të cilin deklarohet se gjendja e detyrimit të mbetur më datë 31.12.2009 është në vlerën prej 1.235.960 lekësh dhe se detyrimi i shlyer brenda vitit 2009 është në vlerën prej 253.240 lekësh;
  - detyrim financiar, kontratë huaje pa interes, me afat 5-vjeçar, në shumën prej 6,000 eurosh. Vlera e detyrimit të mbetur më datë 31.12.2009, deklarohet në vlerën prej 6,000 eurosh.
- ✓ Referuar DPV-2008, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar likuiditete gjendje *cash* apo si shtesa pasurie dhe se nga verifikimi i DPV-ve të tjera vjetore konstatohet se ky subjekt në vazhdimësi ka deklaruar gjendjet e *cash*-it dhe jo shtesa e pikësime të tij.

#### **23.4. Hetimi i kryer nga Komisioni u përqendrua në analizën financiare të të ardhurave të subjektit për krijimin e kësaj pasurie, burimin e krijimit të saj, si më poshtë:**

**23.4.1.** Nga kërkimi i bërë në ZVRPP Tiranë nuk është konfirmuar regjistrimi i kësaj pasurie. Ndërkohë, me dorëzimin e Deklaratës-Vetting, subjekti ka dorëzuar kontratën e sipërmarrjes të datës 15.05.2009, të lidhur ndërmjet tij në cilësinë e “*porositësit*” dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me NIPT \*\*\*, përfaqësuar nga z. R.Z., në cilësinë e “*palës sipërmarrëse*”.

**23.4.2.** Nga verifikimi i kësaj kontrate sipërmarrjeje konstatohet se objekti i saj është prenotimi dhe dorëzimi i një **dyqani, nr. \*\*\*, nën tokë**, me sipërfaqe të dyqanit prej 45.56 m<sup>2</sup>, që ndodhet në pallatin në rrugën “\*\*\*\*”, ndërtuar sipas lejes së ndërtimit të dhënë nga KRRT Bashkia Tiranë me nr. \*\*\*, datë 26.07.2002, dhe planimetrisë së dyqanit. Gjithashtu, pasqyrohet se dyqani është ndërtuar sipas projektit dhe planimetrisë që i bashkëlidhen kontratës. Por, projekti dhe planimetria nuk i janë bashkëlidhur kësaj kontrate të dorëzuar nga ana e subjektit. Në nenin 4 të kësaj kontrate, përcaktohet çmimi i këtij dyqani në vlerën prej 17,780 eurosh.

**23.4.3.** Gjithashtu, në nenin 5 të kësaj kontrate, ku përcaktohen detyrimet e palëve, konstatohet se subjekti i rivlerësimit deklarohet se ka rënë dakord që nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. të blejë dyqanin nr. \*\*\*, nën tokë, kundrejt çmimit të përcaktuar në këtë kontratë dhe se e ka marrë në dorëzim këtë dyqan që në datën e nënshkrimit të kontratës.

- ✓ *Konstatohet se subjekti i rivlerësimit, në vetëdeklarimin e bërë në DPV-2009 dhe po ashtu në Deklaratën - Vetting, e cilëson këtë pasuri si ambient (ish-parkim, garazh), ndërkohë që referuar kontratës së sipërmarrjes së lidhur me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., kësaj pasurie i referohen me emrin “dyqan”.*
- ✓ *Komisioni ka pasur dyshime në lidhje me mënyrën se si subjekti i rivlerësimit në deklaratat e dorëzuara në ILDKPKI e ka deklaruar/përshkruar këtë pasuri në vazhdimësi si ambient ish-parkim, garazh.*

**23.4.4.** Subjekti i rivlerësimit është pyetur nëse ky objekt është blerë si garazh nga ana e tij dhe më pas është transformuar në njësi tregtare, duke i kërkuar edhe informacion lidhur me shpenzimet e kryera për konvertimin. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se: *“Objekti për të cilin bëhet fjalë është transformuar nga vetë shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., nga “garazh” në “njësi shërbimi”*. Në vijim të deklaramit ai shpjegon se, në momentin kur firma ndërtuese ka kryer punimet për transformimin (përshtatjen) e ambientit “ish-garazh”, është realizuar nga ana e tij blerja e kësaj pasurie. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit sqaron se objekti ndodhet në katin nën tokë të pallatit ku ai vetë banon dhe se deri në momentin që nga shoqëria është ndryshuar destinacioni nga “garazh” në “njësi shërbimi”, nuk është shfrytëzuar prej askujt. Në përfundim të deklaramit, ai shpjegon se nuk është realizuar asnjë shpenzim nga ana e tij për transformimin e këtij objekti, por se ka realizuar shpenzime vetëm për lyerjen e tij.

**23.4.5.** Në vazhdim të veprimeve verifikuese-hetimore, Komisioni me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.04.2018, i është drejtuar shoqërisë “\*\*\*” për t’i kërkuar informacion lidhur me shitjen e pasurisë dyqan kundrejt subjektit të rivlerësimit, dokumentin e pronësisë, kontratat e nënshkruara, faturat tatimore, pagesat e kryera dhe mënyrën e kryerjes së pagesës, si edhe çdo të dhënë tjetër që kjo shoqëri disponon lidhur me marrëdhënien me subjektin e rivlerësimit.

**23.4.6.** Në përgjigje të kërkesës së bërë nga ana jonë, shoqëria “\*\*\*” sh.p.k. na ka informuar se për njësinë tregtare të ndodhur po në rrugën “\*\*\*”, në të njëjtin objekt me apartamentin, nuk është lidhur kontratë momentalisht dhe se për këtë arsye, nuk disponon as kontratën e sipërmarrjes dhe as kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie. Lidhur me pagesën e kryer nga z. Adriatik Cama, për blerjen e kësaj pasurie, sqaron se është kryer *cash* dhe se është pasqyruar në mandatpagesat në bilancet e shoqërisë ndër vite. Gjithashtu, kjo shoqëri na informon se kjo pasuri fillimisht ka qenë garazh makinash dhe është përshtatur për njësi.

**23.4.7.** I pyetur nga ana Komisioni për momentin dhe mënyrën e likuidimit të çmimit prej 17,780 eurosh për blerjen e ambientit (ish-parkim, garazh), ndër të tjera subjekti i rivlerësimit deklaroi se: *“Ambienti ish-parkim/garazh është blerë më datë 15.05.2009 nga shoqëria ndërtuese “\*\*\*” sh.p.k., dhe se pagesa e vlerës prej 17,870 eurosh është kryer cash, transaksion për të cilin është lëshuar mandatpagesë”*. Gjithashtu, ai sqaron se dorëzimi i pasurisë nga ana e shoqërisë ndërtuese është kryer po më datë 15.05.2009.

**23.4.8.** Referuar DPV-2009, konstatohet se në rubrikën *“Pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme”* (shtesa/pakësime), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

- shtim pasurie, blerjen e ambientit (ish-parkim/garazh) i përshtatur, në vlerën prej 18,000 eurosh, blerë më datë **15.05.2009**, sipas kontratës së sipërmarrjes të lidhur me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k.;
- shtim pasurie, huamarrje e sasisë prej 6,000 eurosh, shtetasit N.S. më datë 02.05.2009;
- pakësim pasurie, shitje e autoveturës tip “Mercedes-Benz” 201 (190), me targë \*\*\*, për vlerën prej 500,000 lekësh;

- Shtim pasurie, të ardhura nga shitja e autoveturës tip “Mercedes-Benz” 201 (190), me targë \*\*\*, në vlerën prej 400.000 lekësh. Nuk është saktësuar nëse shuma prej 400.000 lekësh është mbajtur *cash*, apo është depozituar në bankë.

**23.4.9.** Konstatohet se në vitin 2009 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shitjen e automjetit tip “Mercedes-Benz” 201 (190), me targë \*\*\*, sipas kontratës noteriale me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 10.12.2009, të redaktuar nga noteri B.M.S., për vlerën prej 500,000 lekësh. Duke qenë se ky automjet është deklaruar si pasuri për herë të parë në DPV-2003, me vlerën prej 300,000 lekësh, nga ana jonë **krijohen dyshime të arsyeshme, të cilat kanë të bëjnë me vlerën reale të deklarimit të blerjes apo të shitjes** së këtij automjeti nga ana e subjektit të rivlerësimit, pasi duket i dyshimtë fakti që ky automjet, mbas më shumë se rreth 6 vitesh (llogaritur këtu amortizimin e tij) të shitet 200,000 lekë më shumë se çmimi i deklaruar i blerjes.

### **23.5. Analiza e të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie**

**23.5.1.** Nga verifikimi i vetëdeklarimit të subjektit të rivlerësimit konstatohet se si burim të krijimit të kësaj pasurie ka deklaruar *të ardhurat nga pagat e tij dhe të bashkëshortes së tij për vitin 2009, kredinë e marrë në “Raiffeisen Bank” (Midea) në vitin 2009, si edhe huan e marrë nga shtetasi N.S. (djali i dajës së tij) në vlerën prej 6,000 eurosh.*

**23.5.2.** Referuar kontratës së sipërmarrjes të datës 15.05.2009, konstatohet se çmimi i shitjes së kësaj pasurie është në vlerën prej 17,780 eurosh, e konvertuar me kursin mesatar të Bankës së Shqipërisë për muajin maj të vitit 2009, në vlerën prej **2,346,960 lekësh.**

**23.5.3.** Të ardhurat nga paga për muajt janar - maj të vitit 2009 të subjektit të rivlerësimit, sipas vërtetimeve të pagave, janë në vlerën totale neto prej **449,845 lekësh.** Nga verifikimi i llogarisë bankare të pagës në “Raiffeisen Bank” konstatohet se në total të ardhurat nga paga neto, të cilat janë kredituar në llogarinë e subjektit të rivlerësimit, janë në vlerën prej **447,445 lekësh.**

**23.5.4.** Të ardhurat nga paga për muajt janar - maj të vitit 2009 të bashkëshortes së tij, sipas vërtetimeve, janë në vlerën totale prej **155,907 lekësh.** Nga verifikimi i llogarisë bankare të pagës në “Raiffeisen Bank”, konstatohet se në total të ardhurat nga paga neto, të cilat janë kredituar në llogarinë e kësaj shtetaseje, janë në vlerën prej **157,597 lekësh.**

**23.5.5.** Nga verifikimi i llogarisë bankare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, me nr. \*\*\*, konstatohet se më datë 08.05.2009 është disbursuar kredia në vlerën prej **1,000,000 lekësh.** Po ashtu, konstatohet se po në këtë datë është kryer pagesa prej **349,393 lekësh** për mbylljen e një kredie të mëparshme të disbursuar më datë 25.02.2009 dhe se është tërhequr *cash* shuma prej 600,000 lekësh, shumë e cila është deklaruar edhe në DPV-2009 si burim për krijimin e kësaj pasurie.

**23.5.6.** Pra, të ardhurat totale të deklaruara si burim i krijimit të kësaj pasurie të blerë më datë 15.05.2009, sipas vetë deklarimit, janë:

- të ardhura nga pagat, vlera totale prej 605,042 lekësh;
- shuma prej 600,000 lekësh, nga kredia e marrë në “Raiffeisen Bank”;
- huaja prej 6,000 eurosh, e konvertuar me kursin mesatar të Bankës së Shqipërisë për muajin maj të vitit 2009, në vlerën prej 792,000 lekësh;

---

Totali i të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie në vlerën prej **1,997,042 lekësh**.

**23.5.7.** Në vijim, nga ana jonë u llogaritën *shpenzimet minimale të jetesës*, sipas përbërjes familjare, për periudhën janar 2009 -15 maj 2009, nga ku rezulton se:

- Shpenzime minimale jetese janë përlllogaritur në vlerën prej **299,545 lekësh**<sup>9</sup>;

**23.5.8.** Nga diferenca e bërë midis të ardhurave totale neto, të deklaruara si burim i krijimit të kësaj pasurie, me vlerën neto të pasurisë së blerë më datë 15.05.2009 dhe shpenzimeve të llogaritura për këtë periudhë, konstatohet se **ky subjekt ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie, në shumën prej rreth 650,000 lekësh.**

**23.5.9.** Gjithsesi, për një analizë sa më të drejtë, kryesisht në favor të subjektit të rivlerësimit, meqenëse në kontratën e sipërmarrjes për blerjen e kësaj pasurie nuk është përcaktuar qartë mënyra dhe data e përfundimtare e likuidimit të çmimit, nga ana jonë për efekt analize do të merren të ardhurat totale të përfituara nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij për vitin 2009, duke bërë analizë vjetore lidhur me pasuritë e krijuara, të ardhurat dhe shpenzimet e kryera për këtë vit.

**23.5.10.** Siç e kemi sqaruar edhe më lart, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar detyrim ndaj shoqërisë ndërtuese në fund të vitit 2009, çka do të thotë që ka shlyer të gjithë vlerën për blerjen e kësaj pasurie që në vitin 2009.

**23.5.11.** Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje (vërtetimet e pagave), konstatohet se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, për vitin 2009 kanë përfituar në total të ardhura nga pagat në vlerën prej **1,495,397 lekësh**. Siç e kemi konstatuar edhe më lart, për vitin 2009 subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë marrë kredi në vlerën prej 1,000,000 lekësh, nga të cilat rreth 350,000 lekë bashkëshortja e tij i ka përdorur për shlyerjen e një kredie tjetër, ndërsa shumën prej 600,000 lekësh i ka tërhequr *cash* dhe i ka deklaruar si burim për krijimin e pasurisë së paluajtshme në vitin 2009. Në të njëjtin vit, ky subjekt deklaroi se ka marrë hua shumën prej 6,000 eurosh.

---

<sup>9</sup> Përlllogaritur nga ana e Komisionit, sipas shpenzimeve të marra nga ILDKPKI-ja, e cila u referohet shpenzimeve minimale vjetore për konsum familjar të INSTAT-it, bazuar në përbërjen familjare. Llogaritjet shpenzimet vetëm për 5 muaj.

**23.6.** Nga ana jonë, me qëllim kryerjen e një analize financiare sa më të saktë, u morën në shqyrtim gjendjet e llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit, bashkëshortes së tij dhe fëmijëve të tij për vitet 2008 dhe 2009, nga ku konstatohet se:

*Ndryshimi i gjendjeve të llogarive bankare nga fundi i vitit 2008 deri në fund të vitit 2009:*

**Tabela nr. 4**

<b>Subjekti i rivlerësimit, Adriatik Cama</b>	<b>Raiffeisen Bank</b>
Gjendje llogarie 31.12.2008	10,879
Gjendje llogarie 31.12.2009	-19,644
Diferenca	- 30,523 lekë

**23.6.1.** Nga verifikimi i llogarisë bankare të subjektit të rivlerësimit në “Raiffeisen Bank” konstatohet se në fund të vitit 2008 gjendja e kësaj llogarie është në vlerën prej 10,879 lekësh, ndërsa në fund të vitit 2009 gjendja e kësaj llogarie është në vlerën prej -19.644 lekësh, çka do të thotë se subjekti i rivlerësimit i llogaritet si burim i mundshëm i krijimit të kësaj pasurie në vitin 2009 vlera prej 30.523 lekësh.

**Tabela nr. 5**

<b>Personi i lidhur, A.C.</b>	<b>Raiffeisen Bank</b>
Gjendje llogarie 31.12.2008	38,438
Gjendje llogarie 31.12.2009	9,446
Diferenca	- 28,992 lekë

**23.6.2.** Nga verifikimi i llogarisë bankare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në “Raiffeisen Bank”, konstatohet se në fund të vitit 2008 gjendja e kësaj llogarie është në vlerën prej 38,438 lekësh, ndërsa në fund të vitit 2009 gjendja e kësaj llogarie është në vlerën prej 9,446 lekësh, çka do të thotë se subjekti i rivlerësimit i llogaritet si burim i mundshëm i krijimit të kësaj pasurie në vitin 2009 vlera prej 28,992 lekësh.

**23.6.3.** Konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DPV-2008 dhe 2009 gjendjet e llogarive në “Raiffeisen Bank”.

Tabela nr. 6

<b>Fëmijët</b>	<b>Raiffeisen Bank</b>
Gjendje llogarie 31.12.2008	-
Gjendje llogarie 31.12.2009	51,913
Diferenca	51,913

**23.6.4.** Nga verifikimi i llogarive bankare të fëmijëve të subjektit të rivlerësimit në “Raiffeisen Bank”, konstatohet se në fund të vitit 2008 gjendja e këtyre llogarive është në vlerën totale prej zero lekësh, ndërsa në fund të vitit 2009 gjendja totale e këtyre llogarive është në vlerën prej 51,913 lekësh, çka do të thotë se vlera prej 51,913 lekësh konsiderohet si pasuri e krijuar përgjatë vitit 2009.

**23.6.5.** Gjithashtu, nga këqyrja e këtyre llogarive konstatohet se ato janë kredituar nga vetë subjekti i rivlerësimit.

✓ *Konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DPV-2008 dhe 2009 gjendjet e llogarive në “Raiffeisen Bank” në emër të fëmijëve të tij.*

Tabela nr. 7

<b>Llogaria bashkëmërore</b>	<b>Intesa Sanpaolo Bank</b>
Gjendje llogarie 31.12.2008	127,977 lekë ose 1,039 euro
Gjendje llogarie 31.12.2009	288 lekë ose 2.1 euro
Diferenca	- 127,689 lekë

**23.6.6.** Nga verifikimi i kësaj llogarie bashkëmërore (në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij), konstatohet se më datë 28.08.2008, nga llogaria në valutë në “Intesa Sanpaolo Bank” në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit është transferuar shuma prej 1,031.76 eurosh në këtë llogari bashkëmërore. Nga analizimi i llogarive në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij konstatohet se ato janë pakësuar përgjatë vitit 2009 në vlerën totale prej 187,204 lekësh. Ndërkohë, konstatohet se llogaritë në emër të fëmijëve janë shtuar përgjatë vitit 2009 në total për vlerën prej 51,913 lekësh.

**23.7.** Sa më sipër, nga ky trup gjykues për efekt analize vjetore do të konsiderohen si të ardhura të mundshme që kanë shërbyer si burim i ligjshëm për krijimin e kësaj pasurie përgjatë vitit 2009 edhe vlera prej 135,291 lekësh. Në vijim, nga ana jonë u llogaritën shpenzimet e njohura, si edhe *shpenzimet minimale të jetesës për konsum familjar*, sipas përbërjes familjare, për vitin 2009, nga ku rezulton se:

- Shpenzime vjetore minimale jetese për këtë periudhë, llogaritur në vlerën prej 798.786 lekësh<sup>10</sup>.

➔ *Të dhënat e analizuara më lart, lidhur me pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, për vitin 2009, reflektohen në tabelën e mëposhtme:*

*Tabela nr. 8*

<b>Përshkrimi</b>	<b>Viti 2009 vlerat në lekë</b>
1. Të ardhura nga pagat subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja	1,495,397
2. Të ardhura nga shitja e makinës	100,000
3. Huat/Kreditë e marra në vitin 2009 <sup>11</sup>	2,183,931
4. Shpenzime për arredim shtëpie <sup>12</sup>	- 83,333
5. Shpenzime jetese <sup>13</sup>	- 798,786
6. Shpenzime për pagesa kredie (principal+interes) <sup>14</sup>	- 737,144
7. Diferenca e gjendjeve të llogarive bankare në fund të vitit 2008 me gjendjet në fund të vitit 2009	150,388
<b>Të ardhura neto (lekë)</b>	<b>2,295,536</b>
8. Blerë dyqan në rrugën “***” <sup>15</sup>	2,438,883
9. Likuiditete <i>cash</i> në banesë (nga shitja e makinës)	400,000
<b>TOTAL PASURI (lekë)</b>	<b>2,838,883</b>
<b>Diferenca e pambuluar</b>	<b>- 528,429</b>

**23.8. Sa më sipër, nga analiza lidhur me pasuritë e krijuara, të ardhurat e ligjshme, si dhe shpenzimet e llogaritura për vitin 2009, konstatohet se ky subjekt ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara përgjatë këtij viti.**

<sup>10</sup> Për llogaritur nga ana jonë, sipas shpenzimeve të marra nga ILDKPKI-ja, që u referohet shpenzimeve minimale vjetore për konsum familjar të INSTAT-it, bazuar në përbërjen familjare.

<sup>11</sup> Këto të ardhura përfaqësojnë shumën prej 360,911 lekësh të kredisë së disbursuar më datë 25.02.2009 në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, kredisë në shumën prej 1,000,000 lekësh të disbursuar më datë 08.05.2009 në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, si edhe të huas në vlerën prej 6,000 eurosh, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit.

<sup>12</sup> Shpenzimet për arredim, shpërndarë ndër vite vlera e vetëdeklaruar nga subjekti, duke qenë se nuk përcakton vitin konkret të arredimit të shtëpisë.

<sup>13</sup> Referuar shpenzimeve minimale vjetore të jetesës sipas ILDKPKI-së.

<sup>14</sup> Nga të cilat 183,241 lekë pagesa principali dhe interesa për kredinë e marrë më datë 08.05.2009 në vlerën prej 1,000,000 lekësh, 390,611 lekë pagesa principali dhe interesa për kredinë prej 360,911 lekësh të marrë më datë 25.02.2009 (të mbyllur në vitin 2009) dhe 163,292 lekë pagesa principali dhe interesa për kredinë e marrë në vitin 2007 prej 300,000 lekësh.

<sup>15</sup> Konvertuar vlera në euro e blerjes së këtij dyqani (prej 17,780 eurosh), me kursin mesatar vjetor të këmbimit të Bankës së Shqipërisë.

**23.8.1.** Pasi i është kaluar barra e provës në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, subjekti i rivlerësimit, z. Adriatik Cama, ka dërguar prapësimet e tij pranë trupit gjykues, me anë të të cilave pretendon ka disponuar burime financiare për të justifikuar blerjen e pasurisë ish-garazh, dyqan, si edhe mbulimin e diferencës negative të dalë pas rezultatit financiar të vitit përkatës.

**23.8.2.** Mbas vlerësimit me objektivitet të shpjegimeve të subjektit, trupi gjykues vlerëson se ato nuk qëndrojnë dhe mbeten të paprovuara.

**24. Autoveturë, tip “Volkswagen Passat”, vit prodhimi 2002, blerë më datë 01.06.2010, me targë \*\*\*, deklaruar me vlerë 6.000 euro. Pjesa e në përqindje, deklaruar 50 %.**

#### **24.1. Burimi i krijimit në Deklaratën-Vetting:**

- Si burim të krijimit të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhurat e krijuara nga paga e tij dhe e bashkëshortes së tij në vite, si edhe të ardhurat nga shitja e autoveturës tip “Mercedes-Benz”, me targa \*\*\*, në shumën prej 500,000 lekësh.

#### **24.2. Mënyra e fitimit:**

Kontratë shitblerjeje automjeti me nr. \*\*\* kol., nr. \*\*\* rep., e lidhur më datë 01.06.2010.

#### **24.3. Deklarimet e bëra për këtë pasuri në vite:**

- ✓ Është deklaruar për herë të parë në deklaratën e vitit 2010 në vlerën prej 6,000 eurosh. Referuar kësaj deklarate, subjekti ka deklaruar shtim pasurie blerjen e autoveturës tip “Volkswagen Passat”, TDI, vit prodhimi 2002, me targë \*\*\*. Si burim të krijimit ka deklaruar të ardhurat nga shitja e autoveturës tip “Mercedes-Benz”, me targë \*\*\*, të ardhurat nga paga, si edhe të ardhurat nga qiraja vjetore e ambientit (ish-parkim/garazh).
- ✓ Nga deklaratimet e mëparshme konstatohet se subjekti ka gjendje likuiditetesh shumën prej 400,000 lekësh, të deklaruar në DPV-2008, si shtim pasurie nga shitja e autoveturës tip “Mercedes-Benz”, me targë \*\*\*.
- ✓ Në DPV-2010 ka deklaruar të ardhurat nga qiraja e ambientit (ish-parkim/garazh) në total për vlerën prej 360,000 lekësh.

#### **24.4. Hetimi i kryer nga Komisioni u përqendrua në analizën financiare të të ardhurave të subjektit për burimin e krijimit të kësaj pasurie, si më poshtë:**

**24.4.1.** Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje rezulton se ky automjet është blerë sipas kontratës noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., të datës 01.06.2010, të redaktuar nga noteri I.H. Referuar kësaj kontrate, konfirmohet çmimi i blerjes në vlerën prej 6,000 eurosh, shitësi deklaron se këtë shumë do ta marrë me regjistrimin e mjetit, që është kusht për dorëzimin e mjetit.

**24.4.2.** Nga konvertimi i vlerës prej 6,000 eurosh, me kursin mesatar të vitit 2010 të Bankës së Shqipërisë, vlera e këtij automjeti është prej 832,860 lekësh. Nga verifikimi i dokumentacionit të

dosjes së këtij mjete, konstatohet se më datë 04.06.2010 është lëshuar certifikata e pronësisë së mjetit rrugor për këtë autoveturë, në emër të subjektit të rivlerësimit.

**24.4.3.** Si rrjedhojë, bazuar në përcaktimin e bërë në kontratën e shitjes së këtij mjete, prezumohet se likuidimi i shumës prej 6,000 eurosh, nga ana e subjektit të rivlerësimit në favor të shitësit, është bërë më datë 04.06.2010.

**24.5. Analiza e të ardhurave që janë deklaruar si burim i krijimit të kësaj pasurie:**

**24.5.1.** Subjekti i rivlerësimit, në Deklaratën-Vetting ka deklaruar se një nga burimet e krijimit të kësaj pasurie është vlera prej 500,000 lekësh nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz” në vitin 2009. Ndërkaq, referuar DPV-2009, konstatohet se ky subjekt ka deklaruar si shtim pasurie për këtë vit vlerën prej 400,00 lekësh nga shitja e këtij automjeti.

**24.5.2.** Gjithashtu, nga ana jonë në analizën financiare të bërë për vitin 2009 shuma prej 400,000 lekësh është konsideruar si pasuri e krijuar gjatë këtij viti, ndërsa shuma prej 100,000 lekësh (diferenca e çmimit të shitjes me gjendjen e likuiditeteve të deklaruara më datë 31.12.2009) është konsideruar si e ardhur që ka shërbyer për krijimin e pasurive të këtij viti dhe gjithsesi ka rezultuar se ky subjekt ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shtesën e aseteve përgjatë vitit 2009.

**24.5.3.** Sa më sipër, nga ana jonë merret e mirëqenë shuma prej 400,000 lekësh si burim i krijimit të kësaj pasurie, shumë e përfutur nga shitja e automjetit të mëparshëm dhe e deklaruar si shtesë pasurie në DPV-2009.

**24.5.4.** Konstatohet se, në Deklaratën-Vetting subjekti i rivlerësimit nuk i ka deklaruar si burim të kësaj pasurie (autoveturës) të ardhurat nga qiraja.

**24.5.5.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit që është administruar në dosje, nuk konstatohet që ky subjekt të ketë dorëzuar kontratë qiraje për sa i përket vitit 2010, me anë të së cilës të dokumentohet krijimi i të ardhurave nga qiraja, si edhe pagesa e tatimit, si kërkesë e ligjit për t’i konsideruar këto të ardhura si të ardhura të ligjshme.<sup>16</sup>

**24.5.6.** Për pasojë, pjesa e të ardhurave nga qiraja, deklaruar si burim i krijimit të kësaj pasurie në DPV-2010, nuk do të merren në konsideratë në analizën që do të bëhet nga ana jonë si të ardhura që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie.

**24.5.7.** Si burim tjetër i krijimit të kësaj pasurie, në Deklaratën-Vetting janë deklaruar të ardhurat nga pagat të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij ndër vite, ndërsa në DPV-2010 janë deklaruar të ardhurat nga pagat.

---

<sup>16</sup> Pika 3 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

**24.5.8.** Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore, të dorëzuara nga ky subjekt në ILDKPKI, konstatohet se deri në fund të vitit 2008 nuk janë deklaruar gjendje likuiditetesh, kursime, qoftë brenda apo jashtë sistemit bankar (*cash*) si shtesa pasurie, nga paga. Siç e kemi theksuar edhe më sipër, vetëm në DPV-2009 ky subjekt ka deklaruar shtesën prej 400,000 lekësh, të krijuar nga shitja e autoveturës tip “Mercedes-Benz” në vitin 2009.

**24.5.9.** Gjithashtu, nga këqyrja e DPV-ve vjetore, të dorëzuara ndër vite nga ky subjekt në ILDKPKI, është konstatuar se vetëm në vitin 2003 dhe 2004, ky subjekt ka deklaruar likuiditete jashtë sistemit bankar, por për të cilat ka bërë përshkrimin se janë **gjendje** dhe jo shtesa pasurie dhe që nga viti 2005 e në vijim nuk ka deklaruar gjendje likuiditetesh, çka do të thotë që ato janë përdorur si burim krijimi pasurie apo janë shpenzuar brenda vitit 2005<sup>17</sup>.

**24.5.10.** Nisur nga ky arsytim, bazuar edhe në vetëdeklarimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit, edhe në analizën e bërë për vitin 2009, nuk janë evidentuar gjendje likuiditetesh të mbartura nga vitet e mëparshme.

**24.5.11.** Në vijim, nga ana jonë u analizuan të ardhurat nga pagat, të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, për periudhën janar-maj të vitit 2010, kjo për faktit se vetëm këto të ardhura të kësaj periudhe mund të kenë shërbyer si burim i krijimit të kësaj pasuri, pasi:

- kontrata e shitblerjes së automjetit mban datën 01.06.2010;
- si datë përfundimtare e pagesës së shumës prej 6,000 eurosh konsiderohet data 04.06.2010, data kur është regjistruar ky automjet në emër të subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimeve në kontratën noteriale të shitblerjes;
- nga verifikimi i llogarive bankare të pagave në “Raiffeisen Bank”, të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, konstatohet se paga e muajit qershor të vitit 2010 për subjektin e rivlerësimit është kredituar në llogarinë e tij më datë 04.06.2010, ndërsa për bashkëshorten e tij është kredituar më datë 03.06.2010. Gjithashtu, konstatohet se tërheqjet e para në këto llogari për muajin qershor janë kryer 09.06.2010 dhe 10.06.2010, çka na bën të arrijmë në përfundimin se të ardhurat nga paga e muajit qershor të vitit 2010 të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij nuk kanë shërbyer si burim i krijimit të kësaj pasurie.

**24.5.12.** Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje<sup>18</sup> rezulton se të ardhurat totale neto, nga paga e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij për periudhën janar - maj të vitit 2010 janë në vlerën prej 623,213 lekësh.

**24.5.13.** Sa më sipër, të ardhurat totale neto që mund të kenë shërbyer për blerjen e automjetit tip “Volkswagen Passat” në qershor të vitit 2010 janë në vlerën prej 1,023,213 lekësh.

---

<sup>17</sup> Në DPV-2004 ka deklaruar gjendje *cash* në vlerën 400,000 lekë, ndërsa në DPV-2005 nuk ka deklaruar gjendje *cash*, por vërehet se ka shtuar pasurinë duke blerë autoveturën tip “Fiat Punto”, me vlerë 300,000 lekë, të regjistruar në emër të bashkëshortes së tij.

<sup>18</sup> Referuar vërtetimeve të pagave.

**24.6. Analiza e shpenzimeve, të njohura dhe të llogaritura Komisioni:**

- Nga ana jonë janë përlllogaritur si shpenzime minimale jetese për periudhën janar - maj të vitit 2010 vlera prej 332,827 lekësh<sup>19</sup>.
- Gjithashtu janë evidentuar shpenzime të kryera përgjatë këtij viti, konkretisht deri në fund të muajit maj të këtij viti, lidhur me pagesat e principalit dhe interesave për kreditë e marra nga ana e subjektit të rivlerësimit apo bashkëshortes së tij, në total për vlerën prej 116,600 lekësh.

**24.6.1.** Sa më sipër, totali i shpenzimeve për periudhën janar - maj 2010 është përlllogaritur në vlerën prej 449,427 lekësh.

**24.7. Konkluzione:**

**24.7.1.** Nga diferenca e bërë ndërmjet të ardhurave të realizuara dhe të cilat i ka pasur gjendje, me shpenzimet e llogaritura si të kryera nga ana e subjektit të rivlerësimit deri në fund të muajit maj të vitit 2010, konstatohet se totali i burimeve të ligjshme që ky subjekt ka pasur në dispozicion për blerjen e automjetit “Volkswagen Passat” në qershor të vitit 2010 është në vlerën prej 573,786 lekësh.

**24.7.2.** Sikurse e kemi konstatuar edhe më sipër, vlera e kësaj autoveture në total është në shumën prej 832,860 lekësh.

**24.7.3.** Nga sa më sipër, konstatohet se **ky subjekt ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e automjetit të markës “Volkswagen”, i tipit “Passat”, në qershor të vitit 2010, për shumën prej rreth 260,000 lekësh.**

➔ Analiza financiare e vitit 2010, e përgatitur nga ana jonë, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

**Tabela nr. 9**

<b>Përshkrimi</b>	<b>Viti 2010 vlerat në lekë</b>
1. Gjendja e likuiditetit në fillim të periudhës 01/01/2010	442,003
2. Blerje autoveture, “Volkswagen-Passat” TDI ***, në vlerën prej 6,000 eurosh	- 832,860
3. Të ardhurat nga paga për subjektin dhe bashkëshorten	1,616,402

<sup>19</sup> Referuar shpenzimeve minimale të jetesës për konsum familjar, sipas përbërjes familjare, përlllogaritur nga ILDKPKI-ja, bazuar në të dhënat e INSTAT-it.

4. Shpenzime për pagesa kredie <sup>20</sup> (principal+interes) dhe shlyerje e një pjese të huas <sup>21</sup>	- 563,116
5. Shpenzime jetese <sup>22</sup> dhe udhëtime <sup>23</sup>	- 809,891
6. Shpenzime për arredim shtëpie <sup>24</sup>	- 83,333
7. Gjendja likuiditeti në fund të periudhës 31.12.2010	126,490
<b>Diferenca e pambuluar</b>	<b>- 357,284</b>

**24.8. Nga sa më sipër, konstatohet se ky subjekt ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shtesën e aseteve/shpenzimet e realizuara përgjatë vitit 2010.**

**24.8.1.** Pasi i është kaluar barra e provës në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, subjekti i rivlerësimit, z. Adriatik Cama, ka dërguar prapësimet e tij pranë trupit gjykues, me anë të të cilave pretendon se disponon burime financiare për të justifikuar blerjen e pasurisë autoveturë në vitin 2010, si edhe mbulimin e diferencës negative të dalë pas rezultatit financiar të vitit përkatës.

**24.8.2.** Mbas vlerësimit me objektivitet të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, Komisioni vlerëson se prapësimet e subjektit janë të pabazuara dhe mbeten pa provuar.

➤ **Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij në Deklaratën-Vetting kanë deklaruar edhe pasuritë e mëposhtme:**

**25. Pasuri të tjera të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit:**

**25.1.** Gjendje *cash*, në shumën prej 1,450,000 lekësh. Burimi i krijimit: Kredia e marrë në “Credins Bank”. Pjesa në përqindje: 50 %.

**25.2.** Punime të kryera në banesën e tij, vlera prej 939,840 lekësh. Si burim krijimi ka deklaruar të ardhurat nga disbursimi i kredisë bankare në “Credins Bank”.

<sup>20</sup> Likuiduar principal dhe interesa kredie për këtë vit, në total shuma prej 285,496 lekësh.

<sup>21</sup> Referuar deklaratës noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., të datës 25.09.2012, si edhe DPV-2010, subjekti ka shlyer në vitin 2010 shumën prej 2,000 eurosh nga huaja e marrë në vitin 2009, konvertuar në lekë me kursin mesatar vjetor të vitit 2010, në vlerën prej 277,620 lekësh.

<sup>22</sup> Shpenzime minimale jetese vjetore, bazuar në përbërjen familjare, të marra nga ILDKPKI-ja, e cila bazohet në të dhënat e INSTAT-it.

<sup>23</sup> Shpenzime minimale udhëtimi, të përlllogaritura nga këshilltari ekonomik, bazuar në të dhënat e sistemit TIMS.

<sup>24</sup> Përpjesëtuat në vite shpenzimet e arredimit, bazuar në vlerën e vetëdeklaruar nga subjekti i rivlerësimit, duke qenë se nuk ka përcaktuar periudhën kur janë kryer këto shpenzime për arredimin e shtëpisë.

**25.3.** Llogari page në bankën “Credins”, gjendja në bankë më datë 30.01.2017, në vlerën prej 239,097 lekësh, ose 903 lekë, që është totali i disponueshëm nga llogaria overdraft;

**25.4.** Gjendje në llogarinë e Fondit “Sicred”, nga llogaria e çelur në shtator të vitit 2015, vlera prej 600,000 lekësh.

**26. Pasuri të deklaruara veçmas nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit:**

**26.1.** Gjendje në llogarinë rrjedhëse më datë 30.01.2017, vlera e deklaruar 505,849 lekë. Burimi i krijimit: Të ardhurat nga pagat dhe kredia nr. 56746, datë 16.12.2016.

**26.2.** Automjet tip “Ford Focus”, me targë \*\*\*, blerë më datë 28.08.2013. Burimi i krijimit: Nga të ardhurat familjare të deklaruara.

**26.3.** Nga hetimi në tërësi i kryer nga Komisioni, nuk rezultojnë dyshime të arsyeshme mbi burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

**26.4.** Dokumentacioni i paraqitur nga subjekti përputhet me deklarin e tij. Gjithashtu, konfirmohet edhe nga dokumentacioni i administruar nga ana jonë në dosje, në kuadër të hetimit administrativ.

**27. Të dhënat nga bankat**

**a. Të dhëna nga “Intesa Sanpaolo Bank”**

**27.1.** Nga verifikimi i llogarisë bankare në “Intesa Sanpaolo Bank” në valutë (euro) me nr. \*\*\*, në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, konstatohet se më datë 21.05.2008 është depozituar *cash* shuma prej 4,000 eurosh, duke krijuar një depozitë bankare. Më datë 28.08.2008, nga kjo llogari bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka tërhequr *cash* shumën prej 3,000 eurosh, me përshkrimin “*shpenzime familjare*”.

**27.2.** Në vijim konstatohet se, po më datë 28.08.2008, shuma prej 1,031 eurosh (e mbetur në llogari) transferohet në llogarinë bashkëmërore, në emrin e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, me nr. \*\*\*. Gjendja e kësaj llogarie më datë 31.12.2008 është në vlerën prej 1,039 eurosh.

**27.3.** Më datë 03.09.2009, bashkëshortja e tij tërheq *cash* shumën e mbetur në llogari, në total vlerën prej 1,050 eurosh.

**27.4.** Nga verifikimi i DPV-2009 konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar si shtesë pasurie gjendjen e likuiditeteve në bankën “Intesa Sanpaolo” më datë 31.12.2009, në vlerën prej 1,039 eurosh.

**27.5.** Lidhur me depozitën e krijuar më datë 21.05.2008, në shumën prej 4,000 eurosh, nga ana jonë u krye analizë financiare e të ardhurave për krijimin e saj, burimin e krijimit të saj, si më poshtë:

*Analiza e të ardhurave:*

**27.6.** Referuar DPV-2007, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shtesa pasurie, gjendje likuiditetesh brenda/jashtë sistemit bankar.

**27.7.** Siç e kemi sqaruar edhe më lart, edhe në DPV-të e mëparshme nuk janë deklaruar shtesa pasurie si gjendje likuiditetesh *cash*, të cilat mund t'i keni pasur gjendje dhe që të shërbenin për krijimin e kësaj depozite në muajin maj të vitit 2008.

**27.8.** Nga verifikimi i llogarive bankare të subjektit dhe të bashkëshortes së tij, në total rezulton se gjendja e llogarive bankare më datë 31.12.2007 është në total në vlerën prej 28,685 lekësh, të pasqyruara si më poshtë:

- gjendja e llogarisë së pagës së subjektit në “Raiffeisen Bank”, më datë 31.12.2007, është në vlerën prej – (*minus*) 26,690 lekësh;
- gjendja e llogarisë së pagës e bashkëshortes së subjektit në “Raiffeisen Bank”, më datë 31.12.2007 është në vlerën prej 55,374 lekësh;

✓ *Konstatohet se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk kanë deklaruar gjendjet e llogarive bankare në DPV-2008.*

**27.9.** Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje vërehet se, në total të ardhurat neto të përfituara nga paga e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, për muajt janar - maj të vitit 2008, janë në vlerën prej 499,205 lekësh.

**27.10.** Sa më sipër konstatohet se të ardhurat totale neto, të cilat mund të kenë shërbyer si të ardhura të ligjshme për krijimin e depozitës në vlerën prej 4,000 eurosh, janë në total në shumën prej 527,890 lekësh.

**27.11.** *Analiza e shpenzimeve, të njohura dhe të llogaritura nga Komisioni:*

- Nga ana jonë janë përlllogaritur se shpenzimet minimale të jetesës për periudhën janar - maj të vitit 2008 janë në vlerën prej 332,827 lekësh<sup>25</sup>.

---

<sup>25</sup> Referuar shpenzimeve minimale për konsum familjar, përlllogaritur nga ILDKPKI-ja, bazuar në të dhënat e INSTAT-it.

- Gjithashtu janë evidentuar shpenzime të kryera përgjatë këtij viti, konkretisht deri në fund të muajit maj, lidhur me pagesat e principalit dhe interesave për kreditë e marra nga ana juaj dhe të bashkëshortes suaj, në total për vlerën prej 52,188 lekësh, si edhe shpenzime minimale të llogaritura për një udhëtim të kryer nga ana e subjektit jashtë vendit, konfirmuar nga sistemi TIMS, në vlerën prej 24,637 lekësh.

**27.12.** Sa më sipër, konstatohet se shpenzimet e llogaritura për periudhën janar - maj të vitit 2008 janë në vlerën prej 409,652 lekësh.

*Konkluzione:*

**27.13.** Nga diferenca e bërë ndërmjet të ardhurave të realizuara dhe të cilat subjekti i ka pasur gjendje, me shpenzimet e llogaritura si të kryera nga ana e subjektit deri në fund të muajit maj të vitit 2008, *konstatohet se totali i burimeve të ligjshme që subjekti dhe bashkëshortja e tij keni pasur në dispozicion për krijimin e depozitës më datë 21.05.2008 është në vlerën prej 118,238 lekësh.*

**27.14.** Sikurse e kemi konstatuar edhe më sipër, vlera e depozitës së krijuar më datë 21.05.2008 është prej 4,000 eurosh. E konvertuar me kursin mesatar vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2008, vlera e kësaj depozite është 492,730 lekë.

**27.15.** Nga sa më sipër, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e kësaj depozite bankare në maj të vitit 2008, për shumën prej rreth 375,000 lekësh.

b. Të dhëna nga “Raiffeisen Bank”

**27.16.** Nga verifikimi i llogarive bankare në “Raiffeisen Bank” konstatohet se në vazhdimësi llogaritë e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij janë kredituar në shuma të konsiderueshme nga individë të ndryshëm.

**27.17.** Kreditimet e llogarive, me të dhënat lidhur me kredituesin, datën e kreditimit dhe shumën e kredituar, paraqiten si më poshtë:

c. Kreditime të llogarisë në valutë, në emrin e subjektit të rivlerësimit:

**27.18.** Nga verifikimi i llogarisë në valutë (euro) në “Raiffeisen Bank”, me nr. \*\*\*, konstatohet se:

- më datë 27.12.2013 është kredituar kjo llogari nga shtetasi B.K., në shumën prej 1,000 eurosh;
- më datë 13.10.2015 është kredituar kjo llogari nga shtetasi B.K., në shumën prej 1,000 eurosh.

**27.19.** Gjithashtu, konstatohet se:

- më datë 27.12.2013, ju keni tërhequr shumën prej 950 eurosh;
- më datë 13.10.2015, ju keni tërhequr shumën prej 1,040 eurosh.

**27.20.** Nga ana jonë, subjekti i rivlerësimit është pyetur nëse për periudhën 2011 - 2017 është financuar llogaria e tij, me vlera më të larta mbi 500 euro.

**27.21.** Në përgjigjet e sjella pranë këtij Komisioni, protokolluar me tonën me nr. \*\*\* prot., datë 21.12.2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se askush nuk ka financuar llogarinë e tij në një shifër të tillë, apo më të lartë.

**27.22.** *Sa më sipër, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë pranë këtij trupi gjykues, lidhur me financimin e llogarive bankare.*

**d. Kreditimet e llogarisë së bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit:**

**27.23.** Nga verifikimi i llogarisë së bashkëshortes së subjektit në “Raiffeisen Bank” konstatohet se kjo llogari është kredituar në vazhdimësi në data të ndryshme dhe me vlera të ndryshme, prej vitit 2007 deri në vitin 2016, nga shtetasit M.M., B.M., dhe B.M., në total për vlerën prej 394,000 lekësh.

**27.24.** Në vijim të veprimeve hetimore, nga ana e Komisionit u kryen veprime për verifikimin e këtyre shtetasve, të cilët kanë kredituar llogaritë tuaja dhe bashkëshortes suaj, nga ku rezulton se këta shtetas janë familjarë të bashkëshortes së tij.

**27.25.** *Sa më sipër, konstatohet se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk kanë deklaruar këto të ardhura të kredituara në llogaritë e tyre ndër vite, si edhe burimin e krijimit të tyre.*

**27.26.** Pasi i është kaluar barra e provës në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, subjekti i rivlerësimit Adriatik Cama ka dërguar prapësimet e tij pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me anë të të cilave ka shpjeguar arsyet e kreditimeve dhe faktin se përse ato nuk janë deklaruar nga ana e tij.

**27.27.** Mbas vlerësimit me objektivitet të këtij pretendimi, Komisioni vlerëson se nuk duket të jenë bindëse shpjegimet e sjella nga subjekti i rivlerësimit.

**27.28.** Në mënyrë të përmbledhur, në përfundim të verifikimeve të kryera dhe të dhënave të siguruara gjatë procesit të hetimit administrativ lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë për këtë subjekt, konstatohet si më poshtë vijon:

- a. Referuar deklaratës së vitit 2003 dhe Deklaratës-Vetting konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë lidhur me vlerën e blerjes së apartamentit.*
- b. Ky subjekt ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara deri në fund të vitit 2003.*
- c. Subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e depozitës bankare në maj të vitit 2008, në emër të bashkëshortes së tij.*
- d. Nga verifikimi i DPV-2009 konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar si shtesë pasurie gjendjen e likuiditeteve në bankën “Credins” në vlerën prej 1,039 eurosh.*

- e. Gjithashtu, konstatohet se në vazhdimësi subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, bashkëshortja e tij, nuk kanë deklaruar gjendjet e llogarive bankare në fund të viteve përkatëse.
- f. Ky subjekt ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shtesën e aseteve për vitin 2009.
- g. Ky subjekt ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shtesën e aseteve për vitin 2010.

**27.29.** *Ka bërë deklaram të rremë pranë këtij trupi gjykues, lidhur me financimin e llogarive bankare të tij, si edhe nuk ka deklaruar këto të ardhura të kredituara në llogaritë e tij dhe bashkëshortes së tij ndër vite dhe as burimin e krijimit të tyre.*

## **28. Konkluzione përfundimtare mbi vlerësimin e pasurisë**

**28.1.** Komisioni, pasi shqyrtoi dokumentacionin e grumbulluar nga hetimi administrativ, si dhe provat e shpjegimet e paraqitura nga subjekti, në përfundim të vlerësimit të kriterit pasuror për këtë subjekt, konstaton se:

- ✓ Referuar deklaratës së vitit 2003 dhe Deklaratës-Vetting konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me vlerën e blerjes së apartamentit.
- ✓ Ky subjekt ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara deri në fund të vitit 2003.
- ✓ Subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e depozitës bankare në maj të vitit 2008, në emër të bashkëshortes së tij.
- ✓ Nga verifikimi i DPV-2009 konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar si shtesë pasurie gjendjen e likuiditeteve në bankën “Credins” në vlerën prej 1,039 eurosh.
- ✓ Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, bashkëshortja e tij, nuk kanë deklaruar gjendjet e llogarive bankare në fund të viteve përkatëse.
- ✓ Ky subjekt ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shtesën e aseteve për vitin 2009.
- ✓ Ky subjekt ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shtesën e aseteve për vitin 2010.
- ✓ Ka bërë deklaram të rremë pranë këtij Komisioni lidhur me financimin e llogarive bankare të tij, si edhe nuk ka deklaruar këto të ardhura të kredituara në llogaritë e tij dhe bashkëshortes së tij ndër vite, si dhe burimin e krijimit të tyre.

**28.2.** Pra, mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimeve, si dhe provat shkresore të administruara në dosje, lidhur me kriterin e vlerësimit pasuror, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit:

- ✓ *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- ✓ *ka kryer deklaram të rremë;*
- ✓ *ka kryer deklaram të pasaktë.*

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

**29.** Procesi i rivlerësimit lidhur me këtë komponent vlerësimi, në referim të germës “b”, të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Adriatik Ismail Cama, me detyrë prokuror, ka vijuar mbështetur në administrimin e dokument/raportit të strukturës përgjegjëse për kontrollin e figurës; procedurës për kontrollin e saj; vlerësimit, verifikimit dhe standardeve të kontrollit bazuar në provat, informacionet konfidenciale, si dhe informacionet e tjera të disponuara nga Grupi i Punës pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK).

**29.1.** Fillimi i procedurës për kontrollin e figurës bazuar në nenin 35 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” referon për subjektin e rivlerësimit, z. Adriatik Cama, fillimisht mbi verifikimin e standardit të plotësimit të deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit, kohës së paraqitjes së deklaratës dhe saktësisë së saj, e cila është dërguar pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

**29.2.** Në referim të shkresës me nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, të DSIK-së, me lëndë “Dërgohet raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Adriatik Cama”, dokument i klasifikuar, me nivel klasifikimi “sekret”, rezulton se formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë nga subjekti, në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**29.3.** Raporti i hartuar pas përfundimit të procedurave të kryera nga Grupi i Punës për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Adriatik Cama, është mbështetur në informacione të kryera dhe dërguara pranë kësaj strukture nga organet ligjzbatuese.

**29.4.** Bazuar në informacionet e këtyre institucioneve, raporti evidenton dhe konstaton ***papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Adriatik Ismail Cama.***

**29.5.** Të dhënat që referohen në këtë raport për subjektin e rivlerësimit, z. Adriatik Cama, disponojnë informacion për atë që nuk cenon sigurinë e burimit, *për përfshirjen e tij në korrupsion gjatë hetimit të disa çështjeve gjyqësore në Prokurorinë e Rrethit Lushnjë.*

**29.6.** Komisioni i Deklasifikimit dhe i Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror” (KDZH) pranë DSIK-së, me vendimin nr. \*\*\*, datë 13.04.2018, vendosi të deklasifikojë pjesërisht raportin nr. \*\*\* prot., datë 02.11.2017, me lëndë “Raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Adriatik Cama”.

**29.7.** Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.03.2018, dërguar pranë DSIK-së, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit kërkon informacione shtesë në lidhje me raportin e sipërcituar, me qëllim realizimin e një procesi të plotë të hetimit administrativ mbi pastërtinë e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Adriatik Cama.

**29.8.** Nisur nga sa më sipër, DSIK-ja me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.05.2018, dërgon raportin e përditësuar, duke integruar dhe informacionet e ardhura pas afatit ligjor të përfundimit të procedurave të kryera nga Grupi i Punës për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Adriatik Cama, raport ky i deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 07.06.2018.

**29.9.** Në raportin e ripunuar jepen detaje në lidhje me informacionin e dërguar nga autoritetet verifikuese, *për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme, konkretisht atë të korrupsionit pasiv të këtij subjekti.* Gjatë kohës që Adriatik Cama ka qenë në detyrën e drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, së bashku me prokurorin Gj.Th. kanë marrë shumën prej XXXX nga familjarët e shtetasit Y.Y., për pushimin e çështjes penale në ngarkim të tij, i cili ishte ndaluar nga Prokuroria e Rrethit Lushnjë për kontrabandë.

**29.10.** Në raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin në fjalë, DSIK-ja vlerëson se *gjendemi në një situatë që evidenton forma të shfaqjes së korrupsionit pasiv, kryerjes së veprimeve/dhënies së urdhrave arbitrare, gjatë ushtrimit të detyrës, ndër radhët e funksionarëve të sistemit të drejtësisë.*

**29.11.** Referuar këtij raporti, *dy prokurorët kanë kërkuar e marrë mitë, nëpërmjet personave të tretë, presonit të ndaluar/nën hetim, për favorizim/pushimin e çështjes në ngarkim të tij, në papajtueshmëri të plotë me detyrën.*

Është gjykuar se *kjo veprimtari e paligjshme i përmbahet përcaktimit të pikës 8, të nenit 3, të ligjit 84/2016, që përfshin veprat penale të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, ku përfshihen “Krimi i organizuar, trafikimi dhe korrupsioni.”*

**29.12.** *Është marrë në analizë dhe periudha në të cilën ka ndodhur fakti, duke qenë se distanca kohore përbën rrethanë lehtësuese, por jo domosdoshmërisht përjashtuese, kur vlerësohet se koncepti thelbësor përcaktues i integritetit profesional të subjektit të rivlerësimit është sistemi i vlerave, element që tregon pastërtinë e figurës së subjektit dhe reflekton përshtatshmërinë e tij për të shërbyer si prokuror.*

**29.13.** Në përfundim, Grupi i Punës pranë DSIK-së, bazuar në germën “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016 ka raportuar se *subjekti i rivlerësimit, z. Adriatik Cama, vlerësohet si individ i mundshëm për t’u vënë nën presion nga strukturat kriminale.*

**29.14.** Nisur nga të dhënat e siguruara nga autoritetet verifikuese, DSIK-ja konfirmon konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, **për papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.**

**30.** Nga ana e tij, ky trup gjykues ka bërë një hetim të thelluar administrativ në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, nga ku paraprakisht, referuar raportit të dërguar nga DSIK-ja, është disponuar informacioni se subjekti Adriatik Cama është përfshirë në korrupsion pasiv së bashku me një prokuror tjetër, lidhur me një çështje të hetuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës Parë Lushnjë.

**30.1.** Për të krijuar bindjen, Komisioni i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme për të marrë dosjen e cituar në raportin e kontrollit të figurës, duke kërkuar gjithashtu dhe një analizë të plotë profesionale (interpretim/opinion ligjor) të kësaj dosjeje.

**30.2.** Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 04.06.2018, Prokuroria e Përgjithshme dërgon informacion të detajuar lidhur me rastin në fjalë, si më poshtë:

**30.3.** Në përmbushje të detyrimeve të parashikuara për organin e Prokurorisë, në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë e Shqipërisë”, nga ana e relatorëve të caktuar për këtë subjekt u kryen verifikimet e nevojshme, duke marrë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë dhe studiuar aktet që lidhen me këtë dosje.

**30.4.** Pas një analize të plotë lidhur me këtë dosje, Prokuroria e Përgjithshme ka konstatuar se vendimi i drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, z. Adriatik Cama, për zëvendësimin e prokurores R.H., nuk është i argumentuar.

**30.5.** Pavarësisht se në këtë vendim *drejtuesi i Prokurorisë përmend bazën ligjore (nenin 27 të K.Pr.Penale), nuk i referohet asnjë prej shkaqeve të parashikuara nga ky nen, për të legjitimuar zëvendësimin e prokurores.*

**30.6.** Gjithashtu, *nga aktet e dosjes nuk rezultojnë shkaqe për përjashtimin apo zëvendësimin e prokurores së çështjes,* sipas kërkesave të nenit 27 të Kodit të Procedurës Penale.

**30.7.** Me vendimin e datës 02.06.2005, prokurori i çështjes, z. Gj.T., bazuar në nenin 328/1, germa “b”, të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, të vitit 2005, me arsyetimin se “*fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale*”. Ky vendim është firmosur edhe nga drejtuesi i Prokurorisë së Shkallës së Parë Lushnjë.

**30.8.** Rezulton se ky vendim pushimi është shfuqizuar me vendimin e datës 05.10.2005 të drejtorit të Drejtorisë së Personelit dhe Inspektimit pranë Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, prokurorit K.B.

**30.9.** Në këtë vendim, prokurori K.B., *bazuar në nenin 24/5 të Kodit të Procedurës Penale e konsideron vendimin e pushimit të këtij procedimi penal si të pabazuar në ligj dhe në prova*, për shkak se nuk janë kryer hetime të plota. Në vendimin e shfuqizimit, i vihet në dukje prokurorit të çështjes se ai, në mënyrë të gabuar, provat e administruara në fashikullin e hetimit i përshkruan si dyshime që duhet të shkojnë në favor të akuzës që duhet të ngrihet për këtë të pandehur. Në vijim, prokurori K.B. ka lënë detyra konkrete për veprimet hetimore që duhet të kryhen për hetimin e plotë e të gjithanshëm të çështjes.

**30.10.** Lidhur me vendimmarrjen e kryer nga ana e prokurorëve për zgjidhjen përfundimtare të këtij procedimi penal, Prokuroria e Përgjithshme konstaton se ***vendimi i pushimit të procedimit penal, që mban datën 02.06.2005, marrë nga prokurori Gj.T. dhe miratuar nga drejtuesi i Prokurorisë, z. Adriatik Cama, ashtu sikurse arsyetohet me vendimin e shfuqizimit të këtij vendimi nga Prokuroria e Përgjithshme, është i pambështetur në ligj e prova.*** Vendimi është marrë në kundërshtim me kërkesat e nenit 327 të Kodit të Procedurës Penale që ka qenë në fuqi në kohën që po hetohej procedimi penal, pa u kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore.

**30.11.** Edhe lidhur me këtë çështje, subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij ka kërkuar thirrjen dhe pyetjen e dëshmitarëve

**30.12.** *Komisioni, me vendimin e datës 05.07.2018, në mbështetje të pikës 6 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur ta refuzojë këtë kërkesë të subjektit të rivlerësimit, si të pabazuar në ligj e në prova.*

**30.13.** Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se: *Subjekti i rivlerësimit, z. Adriatik Cama, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 39 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016.*

## **V. KONKLuzioni Përfundimtar**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të pasurisë.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe të nenit 63, pika 3, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Adriatik Cama, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe do të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 12.07.2018.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**GENTA Tafa (BUNGO)**

**Kryesues**

**SUELA ZHEGU**

**Anëtar**

**PAMELA QIRKO**

**Relator**

**OLSIDA GOXHAJ**

**Sekretare gjyqësore**